

Shënime të pabotuara, shkruar më 4 dhjetor 1969

DH. SHUTERIOQI PËR VETEN DHE TË TJERËT



(fq. 2-4)

NË VEND TË IN MEMORIAM

AGIM MATO YNË I MADH

Nga Anton Nikë Berisha

Nuk është thënë rastësisht se poetët (shkrimtarët) e mëdhenj nuk vdesin; në çastin kur pushojnë së frymuari, këmbehen vetvetiu me poezinë e tyre, me atë që na e kanë krijuar dhe na e kanë lënë trashëgim.

SHËNIME PËR LIBRAT

LUMO SKËNDO PËR SULIN DHE SULJOTËT

Nga Enver Kushi

(fq. 8)

Për një kapitull historik me protagonist autorin Besnik Mustafaj

Nga Skënder Karriqi

(fq. 5)

"Extra time" i Durim Taçit

KOHA SHITESË NË 7 VJET E 7 DITË

Nga Visar Zhiti

(fq. 13)

"Dashuritë e virgjërshës Madalenë" i Ridvan Dibrës

"HIMENI" I GRUAS SI "VRIMË E ZEZË" E NJERËZIMIT

(fq. 10)

Nga Ballsor Hoxha

MARIO CALIVA:

Teatri në funksion të ruajtjes së kulturës arbëreshe

Bisedoi: Mimoza Hasani Pllana

(fq. 22)

"Elementet që ne përdorim në teatrin arbëresh janë ato që kanë të bëjnë me jetën e përditshme, me mënyrat e të folurit, me situatat që mund të shpjegojnë, edhe në mënyrë alegorike, gjenden tonë ekzistenciale. Por, teatri në gjuhën arbëreshe është gjithashtu i rëndësishëm për mbrojtjen e gjuhës sonë. Sepse aktori studion një dramaturgjë arbëreshe. Dhe, për këtë arsye, ai ka mundësinë të fusë termat e humbur në kompetencën e tij gjuhësore. Shikuesi, gjithashtu përfiton, sepse ai i dëgjon këto terma nga goja e aktorit dhe, mbase, mund t'i përdorë përsëri."

TIM PARKS PËRKTHYESI I PADUKSHËM

ALEANCA LETRARE MË E MADHE E TË GJITHA KOHËRAVE: JU, AUTORI DHE PERSONAZHI

Nga Lisa Zeidner

(fq. 20)

BIBLIOTEKË

Desara Tollumi

(fq. 9)

Vajza Hije

Nazif Agalliu

(fq. 11)

Panteoni i qytetërimit që ecën

Besa Kalaja

(fq. 17)

Lojë

Jo Nesbo

(fq. 14)

Radha

Shkëlzen Halimi

(fq. 15)

Berta

Artur Spanjoli

(fq. 16)

Perëndime që kthehen përherë

I. B. SINGER

(fq. 19)

Lavdërim i përmortshëm

për një lidhëse këpucësh

NË KËRKIM TË KOKËS SË HUMBUR

Nga Pol Milo

DH. SHUTERIOI PËR VETEN DHE TË TJERËT

Tiranë, 4.12.1969

Rikopjoj disa shënime që kam marrë vjet në Durrës në disa copa letrash.

Nga brezi im kam çmuar (në kohën kur nisën të botojnë, në vitet 30): Migjenin (shumë), Petro Markon (gjithashtu), Chri-Chrinë (disi), Ramë Voglin e Nexhat Hakinë e Shevqet Musaranë (diçka), Aleks Çaçin, Andrea Varfin, Sterjo Spas-sen (pak) Kapën, Kokonën, Haxhiademin (hiç). Haxhiademin e kam gjykuar artificial. Më pëlqeu Koliqi, shumë Lazgushi dhe Kuteli, disi Noluguzi. Fishta më prekte fort. Naimi si askush; fort edhe Çajupi, De Rada, Dara, Serembe, por jo dhe kaq

akoma Mjeda, të cilin unë çmova megjithatë më shumë se shokët e mi, Haki Stërmilli nuk më tërhoqi. Asdreni më la thuase të ftohtë, Prenushin e injorova, Lame Kodrën e kam pëlqyer, por nuk më ngrohte sa do të kisha dashur. Gramenon dhe Postolin i kam lexuar si të gjithë. Kam adhuruar Nolin, Konicën gati s'e kam njohur, ose e njoha tepër pak.

Gratë më kanë rënë në qafë, kurse unë jo. Kam vuajtur nga njëfarë timiditeti ndaj tyre, në mos droje. Kur më janë vardisur, nuk kam ngurruar. Mendoj se gratë janë po aq "të pabesa" sa edhe burrat, ndonëse përmbahen më shumë, - i për-



ban syri i shoqërisë. Përpara Kantit do të ishin njësoj fajtorë, se "nieti" s'u mungon, ndonëse mund ta realizojnë shumë më pak se burrat. E kanë në instinkt që të kërkojnë të pëlqehen, të përkëdhelen, të bëjnë naze. Zbulojnë mishrat pa ardhur mirë pranvera dhe u pëlqen. Që te syri e te dora, natyrisht, rruga është e gjatë, po, por kur paraqitet rasti, ajo shkurtohet në mënyrë aq të papritur, sa nuk ta pret mendja.

S.....e kam dashur për përkëdheljet, po jo me pasion. Edhe ajo po ashtu? Blansha qe grua plot gojën dhe e kam çmuar shumë si njeri e si femër, por nuk e desha me pasion, si më deshi. Dashurinë e madhe e njoha me Myneverin. Për një grua si kjo, mund të kishe lënë kokën qekuri. E zgjata eksperiencën e dashurisë dhe zgjodha. Është e vetmja rrugë ndofta për të jetuar i lumtur në çift.

S'jam gjeloz. "Tradhëtinë" që do të më bënte gruaja haptazi, do ta falja; fshehurazi, - jo. Fshehurazi fillon pabesia.

Do të kisha qenë fatkeq po të mos kisha pasur fëmijë. Kjo më cvordhi nga Blansha, kjo do të më kishte cvjerdhur nga S....., prapë kjo nuk do të më kishte cvjerdhur nga Myneveri.

Im atë vdiste për fëmijët, nëna ime jo. Unë po çmendem edhe pas tim nipi.

Do të kisha qenë udhëtar i përjetshëm. Zbulova se nuk ka vend që s'është i bukur.


Më ka pëlqyer natyra, veçimi, soditja, jo rrëmuja e qytetit, shokët e tepërt, panaiet, ahengjet.

Më ka pëlqyer mali më shumë se deti. Isha njohës i florës alpine. Për një "edelweis" desh kam lënë kokën. Për një "rodedendron" apo "lys mar-tagon" kam ecur edhe 7 orë e 8.

Mal më të bukur se Tomori nuk njoh, - ndofta sepse jam shqiptar!

Kam qenë gjithmonë krenar se linda në Shqipëri dhe e kam pasur tmerr të mos vdes këtu. M'u paraqitën raste të mos kthehesha, - u ktheva!





Më pëlqen të vishem mirë. Tani, në pleqëri, po vishem keq. Kështu edhe për të ngrënë.

U bëra njohës i kuzhinave, i gjellëve, ndonëse student i varfër. Më kanë pëlqyer shumica e kuzhinave, po jo ç'gatuajnë rusët, çekët, polakët. Serbët e bullgarët i ka mësuar Turqia të hanë. Ëmbëlsirat s'i kam dashur, as pijet. Po kam pirë një okë raki dhe s'jam dehur.

I kam admiruar gjithmonë "ashikët" (im atë që i tillë). Karasevdallinjte, -- jo.

Komoditetin e kam dashur minimal. As qili-ma as mobilje të luksit. Kam dashur të kem një shtëpi timen, ndërtuar sipas qejfit tim, projektuar prej meje, jo për instinkt të pronës, po për një dhomë pune e biblioteke, ku të punoj e të mos më shkojë mendja të dal, dhe për një vatër e oxhak.

Pasurinë s'e kam çmuar asnjëherë. Parinë s'kam ditur ta ruaj. Të mos ishte Myneveri, do të isha pa brekë.

Midis njerëzve të thjeshtë, veten e kam gjetur zakonisht mirë; midis të mëdhenjve, -- rrallë. Të thjeshtët gjithmonë i kam dashur e më kanë dashur, -- të mëdhenjtë zakonisht më kanë çmuar.

Ndër punëtorët, në zemër më ka hyrë minatori, -- ndër fshatarët, malësori. Për ta kam pasur e kam dëshirë të shkruaj. Mirditori më ka magjepsur, si dhe shpataraku, dhe s'po lahem dot me ta.

Zakonisht hesht e dëgjoj, po kur nis e flas, mund të të shurdhoj.

Kam imagjinuar, -- që kur vajta në universitet e më zbuluan një "ekstrasistol", -- se kam sëmundje. Arrita të kem disa sëmundje, po s'kam njohur dëme të mëdha as nga zemra, as nga mëlçia, as nga endoarteriti, as nga veshkat. "Të tëra të vinë nga nervat", më ka thënë ka mot Dr. Hoxha në Tiranë, Dr. Hajnali në Budapest, Dr. Milku dhe Perhoni në Bukuresht, Dr. Petrovski e Vishnevski në Moskë. Arrita t'u besoj. Po për shëndetin, edhe pse jam frikur, s'kam pasur kujdes kurrë, veç kur kam rënë në shtrat. Kam punuar pa hesap, gjer në 16 orë e më shumë ditën, kam pirë duhan pa hesap, gjer në 100 gram me llullë, i kam prishur tërë dietat me t'i filluar.

Terjaqi i llullës. I kafes, jo. Dua të shijoj çdo duhan të ri që njoh, andaj edhe s'e pres dot kurrë seriozisht duhanin.

Kumar s'kam lojtur, po mësova shumicën e loj-nave, gjer te pokeri e bilardua. Brixh, -- jo.

Mendova se po të jetoj 49 vjeç ("gjysmë shekul-li pa një"), boll do të ishte. U bëra 53. S'kam jetuar e do të jetoj plus pra, e kam... qelepir.





Shuteriqi me bashkëshorten Myneverin



Shuteriqi me bashkëshorten Myneverin, dy vajzat dhe djalë



Shuteriqi me bashkëshorten Myneverin

Pëlqej vërtet vetminë, po më shumë atë çift.
Me Myneverin mund të kisha vajtur gjer në fund
të botës; vetëm -- as gjer në gjysmët.

Mërzitem për së gjati, i “këpus lidhjet”. Isha poet, u bëra prozator; studiova folklorin, vazhdo-
va me historinë e letërsisë, për pak mund të jepem
vetëm pas historisë. Po nuk do të ma mbante të
bëhesha... dramaturg. Kam lindur për kohën e en-
ciklopedistëve dhe më vjen keq disa herë që nuk
u bëra kimist (desha të studioj elektrokimi në
Grenoble, se kish atje një institut me famë, po im
atë s’më la), piktor, botanist (oh! ç’botë e mrekul-
lueshme bimësi!), muzikant, arkeolog... Prapë,
kurrë s’kisha menduar se do t’i vihem ndonjëherë
punës shkencore. Kisha menduar se do të jem
tërë jetën poet (s’ka çudi që të rikthehem përsëri
te poezia, te dashuria e parë, më merr malli keq!).
Më detyroi koha të bëhem historian i letërsisë, si
dhe të merrem me shumë gjëra, po qejfi ma ka
pasur po aq.

Kam pasur gjithmonë kurajo civike, po trim
fizikisht nuk thom se kam qenë. Sportist, -- pak a
shumë. Për ushtar, sigurisht që nuk linda.

Feja më ka mbajtur gjer në moshën 15-16 vjeç
me ritet e saj, ku gjeja shumë poezi. Familja ime
qe e lidhur dobët me kishën. Babai qe skeptik,
nëna praktikonte fare pak.

Këmbëngulës në mendime, po zakonisht ha
arësye, “thyhem”, sado me vonesë, kur filloj e
shoh se s’kam të drejtë.

Nuk jam hakmarrës dhe s’e lejoj hakmarrjen te
askush.

S’kam asnjë gram cmire, asnjë derhem nakari.

Njerëzit i dua me shpirt dhe rrezikoj opor-
tunizmin.

Ndjenjën e drejtësisë e kam të acaruar dhe
rrezikoj të zihem me shumë vetë, me cilindo, për
një gram drejtësi.

Kam preferenca, po jo paragjykime. Ky është
një virtut që ia çmoj shumë vetes, sa më bën edhe
të arësyer, edhe realist, edhe të drejtë, objektiv.

S’jam lajkatar, pale me dy faqe. S’jam as dip-
lomat. Ç’kam, e them bram dhe kjo më dëmton
shpesh në jetë.

Nuk duroj të më marrin nëpër këmbë.

Dukem kryelartë, s’jam asnjë grimë.

Për një kapitull historik me protagonist autorin Besnik Mustafaj

Nga Skënder Karriqi

Këndo hyjneshë...

Për Umberto Eco-n, *Metanarrativiteti*, si përsiatje që bën teksti mbi veten dhe natyrën e vet, ose si ndërhyrje e zërit të autorit që përsiat rreth asaj që po rrëfen, dhe madje thërret lexuesin që t'i ndajnë bashkë përsiatjet e tij, është mjaft më i lashtë se postmodernia. Në fund të fundit ai ulet këmbëkryq te "Këndo hyjneshë...". Që këtë duket se për të (Eco-n) fillimi i letërsisë (nëse Iliadës i referohemi si vepër fillimi) qenkerka metanarrativ dhe kjo metanarrativë si shenjë e postmodernes, s'qenka tjetër, veçse kthim tek fillimi i largët, një konstatim ky që nuk duhet të lihet jashtë vëmendjes, kur është fjala për vetën autoriale. Përtej këtij fakti letrar, më pas vjen historia interesante e letërsisë si një histori psikanalitike e kësaj vete (autoriale), deri në fillimet e postmodernes, kur metanarrativiteti, së pari, është shenja e sigurt e çlirimit të autorit prej kompleksit të inferioritetit ndaj Olimpikut dhe olimpikeve/eve.

Thjeshtimi i autorit

Kur Homeri në veprën e fillimit i drejtohet Muzës, bashkë me arketipin e rrëfimit (homerik), po lindte edhe vesi i kompleksit të inferioritetit të autorit ndaj Muzës, duke e thjeshtuar atë (autorin) në veshin dhe

zërin transmetues të mesazhit përgjegjës të kësaj të fundit, pas lutjes "Këndo hyjneshë..." apo "Rrëfemëni tani, Muza, që mbi Olimp banesën keni-/ ju jeni hyjneshë, ju jeni kudo, shihni gjithçka,/ne dëgjojmë thjesht zhurmë, s'dimë kurrëgjë-/cilët ishin udhëheqësit e Danajve dhe cilët prijësit?.../" Në fakt, kjo ishte mënyra e aedit Homer për legjitimimin e së drejtës së rrëfimit përtej masës njerëzore të kohës dhe hapësirës; kjo ishte mënyra se si ai, paraku Homer, mund të tejkalonte vetveten e zhytur prej rëndese në fund të kohës dhe hapësirës së kufizuar ku ishte. Vetëm Muzat kishin përmasën e gjithkohësisë dhe gjithhapësisë. Aleanca me to ishte alibia më e mirë e përmasimit të vetvetes dhe legjitimitit të së drejtës për rrëfim. Ndonëse rezultatet letrare do të ishin të shkëlqyera, pakti apo aleanca me Muzat flijonte në mënyrë ndrydhëse ndjenjën e autorësisë, të cilën, siç duket mjaftueshëm nga citimi i mësipërm (...ju jeni kudo, shihni gjithçka-/ne dëgjojmë thjesht zhurmë, s'dimë kurrëgjë) Homeri nuk e kishte. Rrëfyeti i gjithdijshtëm i kohëve moderne letrare, nuk ishte dhe nuk është, veçse hija e Muzave që ishin kudo dhe shihnin gjithçka. Me sa duket, postmodernizmi është, para së gjithash, momenti i shpërthimit të autorit të ndrydhur historikisht prej kompleksit të inferioritetit ndaj Hyjneshave, që do të thotë momenti i vetçlirimit të tij, reflektuar ky vetçlir-



im në aspektin metanarrativ të stilit letrar në kohën postmoderne letrare, ku, padyshim, dominon në evidencë të plotë veta e parë autoriale si vetë ndërtuese, madje edhe më tej: si vetë krijuese.

Për një kapitull historik...

Kur është shkruar për tipare postmoderniste të romanit të ri shqiptar pas viteve 90, në fakt është dashur të konceptohet fillimi i një kapitulli të historisë postmoderniste të këtij romani (edhe pse, sipas studiuesve, shenjat janë për një histori të shkurtër), e cila, më së pari, bën beli me metanarrativën si prishje e rregullit klasik të rrëfimitarit të gjithdijshtëm dhe të padukshëm, përndryshe hijes apo variantit modern të Muzave antike. Dhe, nëse këtë kapitull historik (postmodernist) romanor shqiptar do ta detajonim, sikurse është e domosdoshme, me data, tituj veprash dhe autorë, të cilët në këtë moment historik tregojnë se nuk kanë vdekur, sikurse ua kishte shpallur nekrologjinë R Barthes më 1967 në artikullin "Vdekja e autorit", argumenti më kuptimplotë i tij do të përkonte me botimin e romanit *Gjinkallat e vapës*, në vitin 1992, të autorit Besnik Mustafaj, ku, me sa duket, për herë të parë në letërsinë shqipe, veta autoriale jep shenja të sigurta të vetçlirimit prej kompleksit të inferioritetit, me zana-fille olimpike.

Në fakt, Besnik Mustafaj do të tërhiqte vëmendjen e lexuesit dhe kritikës që me romanin e tij të parë "Vera pa kthim", me të cilin, për herë të parë në letërsinë shqipe, vjen një subjekt onirik, i cili, në qoftë se nuk do të kishte zgjim (të personazhit), pra kthim në botën e njëmendë, nuk do t'u linte asgjë mangët veprave evropiane të këtij lloji, që për autor kanë Kafkën, Buxatin, Joneskon, Pirandelon etj. Me sa duket, zgjimi i Sanës ishte haraçi që autori i ri, Besnik Mustafaj, duhet t'i paguante metodës në ikje. Gjithsesi, për ta vendosur analizën në kontekstin historik, do të thoshim se me këtë roman Besnik Mustafaj ezauron faqen moderniste të tij si shkrimtar, për të filluar, pas dy vjetësh, kapitullin postmodernist pikërisht me romanin "Gjinkallat e vapës."

Kronisti i munguar si kushti që legjitimon të drejtën për rrëfim

Vetës autoriale, që në romanin e dytë ("Gjinkallat e vapës") të autorit, i paraprin figura e kronistit, e cila, historikisht, përkundrejt konvencionit të vetës së rrëfimitarit të gjithdijshtëm, ka qenë alternativë narrative, duke u legjitimuar si e tillë me të drejtën e pakundërshtueshme të dëshmitarit synor. Në shenjë metanarrative, nëse nuk do të mungonte, figura e kronistit me kronikat e tij do të na kishte lënë një tekst me siguri më pak argëtues, por më bindës, në kuptimin që lexuesi i sotëm, i ushqyer me konkretësinë e jetës materiale, beson te faktet dhe jo te imagjinata. Por kronisti dhe kronikat e tij mnugojnë...Ndërkaq, logjika narrative nuk i përshtatet dhe aq më pak i bindet faktit të

(vijon në faqen 7)



Në vend të In memoriam AGIM MATO YNË I MADH

“Intelektualët e vërtetë, qi me vetëdije të detyrës s’vet, ushtrojnë profesin e letrave janë syni i kombit; një sy qi merr dritë nga vuetjet e gzimet e kalesës, qi e forcon at dritë në përvojë të së tashmes dh’e flakron si rreze terr-shporuese kah ardhmenija e palindun. Pá veprën dritëpërhapëse t’intelektualvet të njimendët, një komb ásht si i verbti mbi një udhë plot gropa e çarravína të rrezikshme”.

ERNEST KOLIQI

Nga Anton Nikë Berisha

Nuk është thënë rastësisht se poetët (shkrimtarët) e mëdhenj nuk vdesin; në çastin kur pushojnë së frymuari, këmbehen vetvetiu me poezinë e tyre, me atë që na e kanë krijuar dhe na e kanë lënë trashëgim. Pra – fjala e tyre poetike – vazhdon të jetojë dhe të komunikojë me lexuesin e të ndikojnë estetikisht në ta, edhe pse ata nuk janë në mesin e tyre. Ndodh kështu për arsye se poezia që kanë përfutur shpreh shpirtin, ngjiz emrin e tyre dhe lexuesi edhe pse s’ka mundësi ta takojë fizikisht poetin, e takon poezinë e tij dhe kjo e mban lexuesin të pa shkëputur me të.

Këtu, pos të tjerash, qëndron rëndësia e poetëve të mëdhenj; e fjalës së tyre poetike që vazhdon të jetë e gjallë e të komunikojë me atë që e lexon dhe njësohet me të. Duke folur për rëndësinë e artit Karl Gustav Jung-u thoshte “[...] arti përfaqëson një proces vetërregullimi shpirtëror në jetën e kombeve dhe të epokave.”

Pikërisht për këtë fakt arsyetohet shprehja se poetët janë hyjnorë për artin e tyre, për ndikimin estetik që kanë bërë e vazhdojnë të bëjnë me veprat e tyre. Poeti ynë arbëresh, De Rada, thoshte se poezia është si profecia, ndërsa Poradeci theksonte se poezia është hyjnore, i tillë është çdo varg dhe çdo fjalë për arsye se brenda saj është shkrirë shpirti i poetit.

Gjithë kjo që thashë lidhet ngushtë me poetin e Sarandës, Agim Maton, i cili këto ditë u nda fizikisht nga ne; lidhet me poezinë e tij dhe me vlerat që e cilësojnë atë.

Agimi vuajti për poezinë, e pësoi për poezinë, po ajo ishte dhe kënaqësia e tij, frymëmarrja e tij shpirtërore. Këtë e përligjin më së miri poezitë e tij.

Në sistemin e komunistëve ai e pësoi nga poezia, si ndodhi dhe me shumë

sivëllezër të tij krijues në Shqipëri, që, po ashtu, e pësuan rëndë:

*U ndesha me censorë që sterilizonin shpirtrat e poetëve
në dobi të ca perëndive të rreme që kishin populluar dhunshëm planetin.
Për shumë kohë penën ma sekuestruan
si një armë të paligjshme që nuk më takonte ta baja.
Për shumë kohë: “Sus!... sus!”, më ndëshkonin
dhe ngela pa zërin tim, pa gjuhën time, pa librat e mi.*

Mirëpo, pikërisht dashuria ndaj artit të fjalës, ndaj poezisë, e bëri Agimin jo vetëm t’i përballojë vështirësitë, po dhe të ndjejë atë kënaqësinë e pazakonshme që ajo mund t’i shkaktojë poetit: poezia u bë etje dhe ngushëllim shpirtëror, që u përligj dhe u njësua në shprehjen poetike të tij, sa të mëvetësishtme, po aq të pasur. Kështu u vlerësua nga studiuesit shqiptarë dhe nga studiuesit italianë.

Tridhjetë vite jetoi me dashurinë e fshehur për poezinë, të fshehur thellë në qenien e tij dhe kur mbërrin çasti i pritur aq gjatë ndodhi diçka e rëndomtë:

*Kur zbrita sërish pas tridhjetë vjetësh në minierën
e braktisur të poezisë
e po çapitesha në galeritë e lëna përgjysmë,
duke kërkuar arin e fshehur nëpër guva,
veglat e mia të punës
të shpërndara pa kujdes në çaste zemërimi
me perënditë,
ngurova papritur dhe ashtu fluturimthi
bëra të ngjitem lart, ku prej kohësh përgatitesha për
salltanetin e madh të vdekjes (Mea culpa)*

Agim Mato nuk qe vetëm poeti i parë i Sarandës me trojet përreth, po dhe frymëzuesi dhe nismëtar i shumë veprimtarive letrare. Ai, bashkë me Timo Mërkurin, Bardhyl Maliqin e me të tjerë, e ngritën në nivele të larta bashkëkohore “Klubin të krijuesve jonianë” (Agimi për shumë vite ishte kryetar i këtij klubi). Klubi u bë i njohur sidomos për takimin tradicional të quajtur “Trirema e poezisë Joniane”(ide e Agim Matos), në të cilin vite me radhë morën pjesë krijues nga: Maqedonia, Bullgaria, Greqia, Spanja, Italia etj. Saranda ishte i vetmi qytet në Shqipëri që e nxiti një bashkëpunim të përmasave të këtilla me poetët e huaj dhe e vuri në komunikim letërsinë tonë shqipe me letërsinë e tjera.

Natyrisht, merita më e madhe për këtë, i përket Agim Matos.

Me një fjalë, në rrafshin letrar e kulturor Saranda u njësua mirëfilli me emrin e Agim Matos, po edhe ai u njëjtësua me qytetin e tij: organizoi shumë takime letrare, po edhe nxiti krijuesit e qytetit e të rrethinës që të shkruanin e të botonin.

Për t’u ndihmuar atyre, e themeloi dhe shtëpinë botuese “Milosao”, që u bë vatra kryesore e botimeve të veprave letrare të shkrimtarëve të hapësirës joniane. Mirëpo, ai e kaloi dhe këtë kufij: botoi dhe vepra të autorëve të tjerë:





të shkrimtarëve arbëreshë, të shkrimtarëve të Kosovës dhe të shkrimtarëve italianë.

Falë aftësisë dhe këmbëngulësisë së Agim Matos, u krijuan marrëdhënie me disa shkrimtarë të huaj, sidomos me shkrimtarët italianë të Barit, të Leçes, të Tranit, të Formia-s, Gaeta-s etj.

Duhet të përmend sidomos bashkëpunimin shumë të frytshëm me grupin e shkrimtarëve italianë që janë të bashkuar rreth revistës letrare “La Vallisa” (që botohet rregullisht tash mbi 40 vite), të prirë nga prof. Daniele Giancane (Xhankane).

Këmbimi i përvojave me shkrimtarët italianë si dhe botimi i poezive dhe i antologjive në dy gjuhë (shqip dhe italisht), siç është vëllimi *Na bashkon një det. Antologji me poetë italianë dhe shqiptarë të jugut* (Milosao, Sarandë 2016), është punë që lidhet pandërmjetësisht me emrin e Agim Matos.

Më duhet të përmend këtu edhe qëndrimin vëllazëror të Agimit përballë shkrimtarëve kosovarë, një fisnikëri e pafund. Edhe ata ia kthyen këtë të mirë: “Ars klubi Beqir Musliu” i Gjilanit, i drejtuar nga shkrimtari Sabit Rustemi, e ftoi në Gjilan dhe shkrimtarët vendorë e vlerësuan lart poezinë e tij; shtëpia botuese “Faik Konica” e Nazmi Rrahmanit, i botoi vëllimin me poezi të zgjedhura “Shkretëtirë harrimi” (Prishtinë 2018), ku janë përfshirë poezitë e tij artistikisht më të ngritura.

Dhe Agimi ynë i madh bëri dhe punë të tjera për të mirën e letërsisë sonë e për qytetin e vet, Sarandën. Bëri pikërisht atë që e thotë Ernest Koliqi për intelektualin në mendimin e vënë jo rastësisht në krye të këtij shkrimi, që i përgjigjet mirëfilli poetit Agim Matos.

E kam thënë në një shkrim tjetër se kur vdes një shok i shtrenjtë vdes dhe një pjesë e jotja, ndërsa kur vdes një shok dhe poet i madh, vdes një pjesë më e madhe e jotja.

Agim Mato ishte një poet dhe një shok për shembull.

Mendoj që krijuesit jonianë të Sarandës duhet t’i vënë emrin e Agim Matos klubit të tyre. Me këtë do ta nderojnë klubin dhe do ta nderojnë emrin e poetit të tyre e tonin. Kjo do të jetë punë e parë që duhet të bëjnë ata dhe qyteti i tyre për të vazhduar edhe me nisma të tjera.

Prishtinë, 12 maj 2021

(vijon nga faqja 5)

kronistit të munguar. Që në krye të herës, nevoja e referencës ndaj një kronisti është prirja subtile për t’i ikur skemës së Muzës antike apo hijes së saj, rrëfimitarit të gjithdijshëm. Prandaj, edhe pse mungon, ai duhet të ekzistojë ashtu, i munguar, madje i tillë ai është më funksional në aspektin e një narraciani në shenjë e metanarrativës, përndryshe, postmodern. Një kronist i munguar mund të plotësohet dhe ndërtohet si një mundësi e hamendësuar, qoftë në imazhin e atij që shkruan apo rrëfen (kronistit), qoftë në çfarë ai shkruan apo rrëfen (kronikës).

Në këtë pikë, autori (Besnik Mustafaj), në kuptimin autorial të fjalës, duhet ta ketë ndjerë veten mirë. Ai i ka ikur imazhit robërues të të ashtuquajturit rrëfimtari i gjithdijshëm, përndryshe, hijes fantomatike të Muzës, pa ndihmën e së cilës rrëfimi do të ishte i pamundur, siç thonë Homeri dhe Hesiodi (mësuesit e parë) dhe ka ndërtuar imazhin e një kronikani të munguar, i cili, nuk thotë, nuk shkruan, nuk shënon, por vetëm do të kishte thënë, do të kishte shkruar, do të kishte shënuar.


Me sa duket, prania e kushtores është zgjidhje funksionale deri në atë masë sa mund të perceptohet qartë se kjo mënyrë gramatikore vetiu përbën një zgjidhje stilistike për të motivuar dhe legjitimuar të drejtën për rrëfim si plotësim të kushtit (kronistit) të munguar. Që figura e kronistit është shtegu i kërkuar për t’i ikur hijes së Muzës, (përndryshe standardit të rrëfimitarit të gjithdijshëm) kjo duket në shenjë e metanarrativës, që në fillim të romanit, me ndërhyrjen e drejtpërdrejt të autorit, kur ai e quan punën e vet një ushtrim romanesk.

Ushtrimi romanesk pa komplekse

Por ushtrimi romanesk i Besnik Mustafajt nuk mund të përfundonte me figurën e kronistit të munguar. Kur-rë ai nuk do të mjaftohej me një zgjidhje tjetër varësie, qoftë kjo e lidhur me figurën e një kronisti të munguar, kronikat e të cilit duhet t’i shkruante ai, autori Besnik Mustafaj. Duhet t’i tregohej lexuesit se ishte pikërisht ai që zotëronte plotësisht hapësirën romanore të botës së vet të trilluar (romanit “Gjinkallat e vapës”), ishte ai pra një Zot i vërtetë i saj. Gjithashtu ai duhet t’i tregonte lexuesit se në botën e tij të trilluar (“Gjinkallat e vapës”), ishte ai, shkrimtari Besnik Mustafaj, që zotëronte kohën në tri përmasat e saj themelore: të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen dhe si një Zot i kohës në botën e tij, ai e anulonte atë, e kthente mbrapsh, në kundërshtim me rregullin sklavërues të kronologjisë. Ishte ai i gjithdijshmi, i gjithkohshmi, i kudogjenduri dhe kurrfarë hijeje fantomatike e rrëfimitarit të gjithdijshëm nuk ekzistonte. Në fund të fundit, ishte ai vetë, Besnik Mustafaj, Zoti i botës, përkatësisht botëve të tij/a të trilluar/a. Oh sa herë, sa herë (pothuaj vazhdimisht) ai dhe sivëllezërit e tij shkrimtare e kanë ndjerë këtë përmasë hyjnorë përbrenda vetes dhe po kaq herë e kanë ndrydhur sipas kodeve konvencionaliste të Muzave (Hyjnshave) apo rrefimitarit të gjithdijshëm (hijes fantomatike)!

Në këtë përvojë të dytë romanore (“Gjinkallat e vapës”), në koherencë të plotë me impulsin e brendshëm autorial dhe në inkoherencë po të plotë me parimin kronologjik të rrëfimit, në një moment jo thjesht trillan të subjektit, përkundrazi, në një moment stilistik metanarrativ, ai, shkrimtari, autori Besnik Mustafaj, do të shfaqet jo thjesht si rrëfimtari, por edhe si shkruesi e krijuesi i parë. Kur banorët e fshatit, të intriguar nga emri YLL i protagonistit të romanit, përsiaten sipas mënyrës së tyre dhe e quajnë pagëzimin e tij si punë dreqi, autori (BM) ndërhyr drejtpërdrejt, si asnjëherë tjetër, duke thënë: “*Banorët e katundit nuk do e merrnin vesh kurrë se përgjegjësi për atë emër të përveçëm jam unë që po shkruaj historinë e tyre. Yll Përlala me baskëkohësit kanë ndërruar jetë. Por edhe sikur ta merrnin vesh, nuk do ta kuptonin dot mendjelehtësinë, me të cilën unë zgjodha një emër; që ata do t’i vinte gjatë në një siklet të pashembullt, duke gërmuar nëpër kokat e veta të lodhura, për të gjetur, qoftë edhe me vonesë, shenja paralajmëruese, ardhur nga larg, lidhur me munxyrën që po hiqnin natë e ditë.*”

Ky imazh provident i autorit Besnik Mustafaj, shpërfaqur në këtë përvojë të dytë romanore (“Gjinkallat e vapës”) në vitin 1992, kohë kur ai e kishte përpara karrierën letrare, e ve automatikisht nën shenjë e vet (providente) gjithë veprën e autorit. Në këtë kuptim, Besnik Mustafaj arrin të artikulojë dhe legjitimojë imazhin e vet autorial si krijues i botëve të veta letrare: Zoti i kohëve, hapësirave dhe banorëve të tyre, me stil të spikatur metanarrativ, i çliruar prej hijes fantomatike të Muzave apo rrefimitarit të gjithdijshëm, duke shkruar kështu edhe një histori psikanalitike të pasionit për vetën autoriale.



LUMO SKËNDO PËR SULIN DHE SULJOTËT


Nga ENVER KUSHI

Vite më parë, në një nga sallat e Bibliotekës Kombëtare, pata fatin të shfletoja revistën “Diturija”, themelues i së cilës është Mit’hat Frashëri. Ditë dhe javë të tëra u njoha me një nga botimet shqiptare më serioze të kulturuarat shqiptare të gati një shekulli. E megjithatë, ndonëse kam lexuar dhe rilexuar edhe librat “Udhëtarët e huaj në Shqipëri” (gjer në fund të shek XIX) të Lumo Skëndos apo “Mit’hat Frashëri. Ministër Fuqiplotë Athinë (1923- 1926)”, përgatitur falë punës pasionante të Prof Dr Luan Malltezi dhe Sherif Delvina. Institutit që mban emrin e Mit’hat Frashërit, drejtuar nga Uran Butka, ka botuar dhe vazhdon botimin e kolanës të veprës të këtij dijetari të madh.

Unë kam një ndjeshmëri apo detyrim ndaj personalitetit të Mit’hat Frashëri, që lidhet me Çamërinë, rrënjët e të parëve të mi. Çamëria, me historinë, kulturën, trashëgiminë, por edhe me dramën e saj, është pjesë e veprimtarisë krijuese shkencore dhe diplomatike të tij. Krahina e të parëve të mi është njëkohësisht një nga brengat e mëdha të Mid’hat Frashërit. Bindesh për këtë po të lexosh librin “Mid’hat Frashëri, Ministër Fuqiplotë Athinë (1923- 1926)”. E them me bindje, se që nga momenti që ai shkeli në tokën greke me detyrën e re (28 shkurt 1923) e deri sa dha dorëheqjen në muajt e parë të vitit 1926, në mbrojtjen

e çështjes çame dhe përpjekjeve për normalizimin e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Greqisë, ka bërë atë që nuk e kanë bërë të gjithë ambasadorët shqiptarë që nga viti 1926 e deri më sot. Kjo sepse ai kishte një epërsi që nuk e kanë patur pasardhësit e tij: kulturën e gjerë, njohjen e shkëlqyer të historisë dhe kulturës së madhe të Greqisë, si dhe kurajon për të thënë të vërtetat dhe demaskuar synimet e politikës shovene të qarqeve ultranacionaliste greke. Mit’hat Frashëri kishte miq të shumtë në Athinë, personalitete të politikës dhe kulturës së madhe greke.

Çamëria, popullsia e saj martire e të shkuarës, të sotmes dhe të ardhmes, i janë dhe do t’i jenë mirënjohës Mit’hat Frashërit. Të gjitha këto mendime dhe vlerësime modeste për veprimtarinë e Mit’hat Frashërit, më erdhën ndërmend këto ditë, kur rilexova një nga rrëfimet më të bukura e të ndjera, por edhe aktuale të tij, “Suljotët”. Rrëfimi në fjalë (unë do ta quaj reportazh të shkurtër, ndoshta skicë, siç e përcakton Prof Dr Emil Lafe), është përfshirë në librin e Lumo Skëndos (pseudonimi i Mit’hat Frashërit) “Hi dhe Shpuzë”, botuar në vitin 1915, në shtypshkronjën “Mbërodhësia” të Kristo Luarasit në Sofje. Vepra është botuar në vitin 1995 me të njëjtën emër dhe përgatitur, nga prof Nasho Jorgaqi.





Skica “Suljotët”, sipas shënimit të vënë në fund të saj, është shkruar më 30 qershor 1912, në Zafranboll. Sipas të dhënave që jep autori, që në fillim të skicës, Zafranbolli është një qytet në Anadoll, i humbur në një gropë “dhe plot konopë tani në verë”. Me penelata të shpejta, frazë të saktë dhe lakonizëm të admirueshëm (duket se është shkruar me një frymë), autori shpalos një dramë të tërë: zhbërjen e një prej viseve më epike të Shqipërisë dhe banorëve të saj: Sulit dhe suljotëve. Nuk kemi përshkrim të betejave apo heroizmit të suljotëve, as të vvarë. As të plagosur. As vaje apo kuje të nënave suljote. E megjithatë lexuesi ndjen në thellësi, si gjëmime të largëta bubullimash apo dallgë detrash, ulërima.

Qindra kilometra larg Sulit, në Anadollin e largët, shfaqet befas trupi dhe shpirti i plagosur në zhbërje i Sulit: vajzat e vogla të shkollës greke të qytetit Zafranboll këndojnë e kërcejnë vallen e famshme të Zallongut, jo në gjuhën shqipe, jo në dialektin çam të suljotëve, por në gjuhën greke. Autori befasohet, pastaj ...“ zemra ime përnjëherë më ngushtohet dhe mejtime të hidhura më sulen në mendje”. Lumo Skëndo hesht vetëm një çast, për të rikujtuar vizitën e tij në Sul në vitin 1909, ku “një helm i madh më pritte: atje pashë një të keqe, një mëkat që s’rrëfëhet, atje pashë fshatra ku, jo shqiptarëria, por edhe shqipja ka zënë të harrohet”.

Rrëfenja, ose më saktë skica “Suljotët”, që botojmë dhe që njihet pak ose aspak nga lexuesi shqiptar, të vë në mendime dhe të trondit me të vërtetat që kumton.

... Njëqint vite pas rrugëtimit të Mit’hat Frashërit në viset mitike të Sulit, pata fatin të rrugëtoj edhe unë atje. Nuk do ta harroj kurrë këtë rrugëtim nga më emocionuesit, por edhe nga më të dhimbshmit që kam bërë. Atje heroizmi i dikurshëm, qëndresa, këngët, vallet, kishin formën e gurit. Edhe zërat njerëzor dukej sikur kishin ngrirë. Braktisja këtu ishte uluritëse. Shtëpi të braktisura gjysmë të rrënuara ose të rrënuara. Puse. Muret e një kështjelle në bregun përballë Sulit dhe hone të frikshme. Dhe ndërsa vështroja këtë peizash si në fillimbote, befas më erdhi ndërmend kujtesa popullore çame për Sulin, këngët për suljoten e bukur, vallja e Zallongut, kënga për Marko Boçarin ose Marko Çamërinë, siç thuhet në këngët çame. ... M’u kujtua edhe skica “Suljotët” e Lumo Skëndos (Mit’hat Frashërit) dhe m’u bë sikur dëgjova zërin e tij: “ Atje pashë një të keqe, një mëkat që s’rrëfëhet, atje pashë fshatra ku jo shqiptaria, po edhe shqipja ka zënë të harrohet.” Ishte i vetmi zë në atë shurdhëri dhe shkretim me emrin Sul. Në fund po shtoj edhe diçka tjetër, që lidhet me të parët e mi: Ata janë me origjinë nga Suli, prandaj kur isha atje, gjaku më lëvizte ndryshe dhe m’u shfaqën hijet e tyre, si dhe zërat, që nuk e di nga më vinin. Mbaj mend, që u shkëputa nga grupi i xhirimit, hyra në një kishë të vogël dhe ndeza një qiri për të parët e mi suljotë. Bëra dhe kryqin për të nderuar kujtimin e tyre.



SULJOTËT

Nga Lumo Skëndo

Kam një javë këtu në Zafranboll, në këtë qytet të Anadollit, të humbur në gropë, të nxehtë dhe plot konupe tani në verë.

Lumtërisht kam fatnë të gjej një ndënjtje të mirë me një kopsht të bukur rreth e rrotull në këtë mëhallë të krishterë, që njerëzia – ngaqë të dy fetë s’piquenë dot – e shikojnë si një pshat veçan dhe e quajnë Keran- Qoj. Nga penxheret shoh dy vargje malesh të ndarë me një grykë, atë që kam përpara të xveshur dhe gurishte, me anë të djathtë male të zez tërë drurë, pyje të thellë. Nga penxherja tjetër shoh majën e kishës Shënt Stefan, Aja Theodhora e moçme, e cila dhe mbase i ep emërin e qytetit (Theodhorian Polin – Zafranboll).

Kajmekami, miku im z. Kadri Përmeti, më tha që dje se do të vemi në shkollë greqisht të çupavet, të ndodhemi në provimet e tyre, dhe me gëzim e pranova ftimin e tij...

Në sallë të shkollës janë radhitur nja tridhje të çupa, në rreshtat e para; prapa tyre janë djemtë, në mes të tyre disa gjashtë apo shtatë vjeç, po dhe dymbëdhjetë e trembëdhjetë. Provimet rrjedhin mi dhe shkronjë, gjuhë tyrqisht, frëngjisht, orthografi ; nxënësit përsëriten përpara pllakës së zezë dhe kushdo prej të ftuarvet ka të drejtë të pyesë.

Unë po vë re. “Çupat që kam përpara janë të krehura mirë, të kujdesura, të veshura të gjitha me një mënyrë: rroba të bardha me kordhela të kaltërta: ngjyrat e Greqisë! Edhe më vjen keq për këto çupa, për këta djem dhe për mëmat e atërit e tyre që janë radhitur afër murit, më të djathtë e më të mëngjër, më vjen keq për këtë njerëzi pa kombësi, pa gjuhë: flasin vetëm tyrqisht, janë fjesht anadollakë, s’di njeriu nga çkombësi janë, dhe duan të rrëfehen grekër! S’kanë as histori, as kujtime të moçme, as nonjë ndjenjë të tanishme, dhe duan të ngushëllohen me një shtet të vogël atje poshtë, me Greqinë e largët, se ashtu ua do feja, ashtu u ka thënë kasha dhe dhaskali. Edhe vërtet më vjen keq si për jetimë, si për djem pa mëmë, pa baba, pa shtëpi, dhe them: kur s’janë gjësend, dobare le të thonë që janë grekër.

Po dal! Çupat tani më s’po pyeten, kanë zënë e kërcejnë. Ç’është kjo valle, kjo këngë e njohur? “Lamtumirë o jetë e ëmbël.... Suljotka ! ... “në gjuhë greqisht.

Këng e Sulit! Këng e shqipëtarë, këng e vendit tim edhe krahërori më fryhet, zemra më mallohet, më vjen dhe mua t’ia dredh një herë , a t’ia marr me to.

Këng e Sulit! Po shoh ato shqipëtarë trimëresha, ato gra zemër luaneshe, vallen e tyre mi shkëmpt, varur mi rripët, një valle vdekjeje, një zë i qiellit dhe i varrit.! Ushtarët e Ali Tepelenës po afrohen, po sulen, po gratë këndojnë, dridhen, të zëna prej dore, dhe ay vark më çdo grimë humbet nga një shpirt, edhe një nga një gratë lëshohen poshtë shkëmbit, hidhën në greminë, në skëterrë, në gojë të vdekjes që ikapërcen një nga një. Edhe vdesin me këngë në gojë, pa u dredhur zemra e tyre.!

Më mirë vdekje e lirë se sa turp dhe robëri, na fjala e këtyre shqipëtarëve, e sulotkave me kujtim të pavdirshëm, që i apin një emër të përmotshëm kombit tonë, që trimëri e tyre do të inspirojnë gjithnjë poetët e gjithë kombevet ! Suljotët, një grusht njerëz, që kanë mbushur me famën e tyre faqet më të shkëlqyera të historisë së tanishme, që kanë lënë kujtime trimërie të paharruar!

Edhe e ndjeva veten time fatore të jem nga kjo racë, nga ky popull, nga ky dhe, nga këta shkëmbinj që nxjerrin të tillë njerëz, të tilla gra. Edhe krahërori m’u fry edhe një herë duke dëgjuar këtë këngë, këta emra, duke parë këtë valle këtu në këtë qytet të Anadollit.

Po pse zemra ime përnjëherë më ngushtohet dhe mejtime të hidhur më sulen në mendje? A është pse këta suljotë kanë derdhur gjakun e tyre kaq të famshëm për një çështje të huaj, për një komp që s’ish i tyre? – Jo, s’është ky mejtim që më hidhëron kështu, se e di, e kam ditur, dhe gjithë bota e di që dhe këta shqiptarë, si kaq të tjerë, si edhe Sina Pasha, a Qyprului, a Mehmed Aliu, kanë shërbyer një kauzë jo të tyren!

Ajo që më hidhëron është Suli i sotmë.

Ku je, o Sul? N’ato rripat e tua ata njerëz trima a e kanë akoma atë zemër trime, a e dinë që janë shqiptarë, që gjaku shqiptar rreh në rembat dhe në zemrat e tyre ?

Tre vjet po bëhen, kur qeshë në Shqipëri vajçë nga Llura në Llakë të Lelovës, në këtë copë të Sulit . Po sa një helm i madh më pritte: atje pashë një të keqe,një mëkatë që s’rrëfehet, atje pashë fshatra ku, jo shqipëtarëria, po dhe shqipja ka zënë të harrohet ! Si tani po e shoh atë djalë mi mur të Papadhatës, kur m’u përgjigj greqisht fjalës shqipe.- Kush të tha që të mos dish shqip, or bir? – **O dhaskalos**, më tha djaloshi, pa ditur se ç’të vërtetë të helmshime po thosh!

Ah ,jo! E kuptoj që këta anadollakë të gJORë, këta jetimë të varfër të thonë se janë grekër. Po ne, ne shqiptarët, me kujtime, me histori të shkëlqyer, me fytyra dhe emër të ndershëm, ne të themi se jemi grekër, këtë s’m pret dot mendja!

Edhe nuk di, në duhet të kem një cmir të vdekshim për atë “ o dhaskalos” , apo në duhet të më vijë keq për atë djalosh edhe për prindët e tij?

Zafranboll, 30 qershor 1912.

VAJZA HIJE

Tregim nga Desara Tollumi

Mbrëmje e rëndë, e plandosur mbi qiellin e përmbysur nga largimi i diellit, sikur ky largim të mos ishte si çdo largim tjetër që ai kryente çdo ditë. Me sa dukej, dielli ishte fundosur për sot në humbëtirën e atij horizonti të cilit s’e di nëse fund i quhet shtrati i vdekur i oqeanit, e me fundosjen e tij ishte fundosur edhe një pjesë e shpirtit tim. Diku në cepin më të errët të kthinës gjendet një stol prej dru lisi, në anën e majtë të të cilit ndodhet një kosh i vogël i zi, ku mbrapa i qëndrojnë pallatet e veshura me pluhurin e kohës, që i bën të mjerueshme ndër shekuj. Përballë stolit ndodhet një pemë e lartë, e fuqishme, por e lënduar prej asaj që vjeshta po i shkakton, rënies së gjetheve nga degëzat e saj të kafta.

Përtej gjithë syve që e kanë vështruar, si është e mundur vallë që asnjë s’e ka parë se ç’fsheh në të vërtetë ai stol, se ç’ndjenja gëlojnë tek ai dhe se kush shpirtin ka lënë peng prej vetmisë që e rrethon?

Askush s’mund të dëgjojë një zemër që fsheh kuptimin e rrahjeve të saj, e jo më të shohë trajtën e asaj që fshihet pas buzëqeshjeve të vrara dhe frikës së refuzimeve shkatërrimtare. E di që aroma ime fluturon, bashkohet me ajrin e ftohtë të këtij mesomuzgu vjeshtor dhe mbush flegrat e vdekjes, kërcen me melodinë e arratisjes dhe i shmanget së vërtetës që fle tek ti e përumbet në justifikimet që ngjizim të dy së largu nga pak. Edhe këtë e di, që aroma e ëmbël e trupit tim nuk i ngjason aspak aromës fisnike që kërkon ti, e kjo jo se aroma ime s’është aspak dinjitoze apo është e lirë, por sepse ti nuk je përpjekur kurrë ta ndiesh atë përtej komplimentit, aromën e ëmbël të pafajësisë, e cila tejçohet nga trupi im i ngapërthyer në këtë ngrehinë.

Unë ndodhem këtu, s’jam as poshtë me gjethet e zverdhura të rëna në tokë, por s’jam as lart në pemë, në ato degëza që as era s’mund t’i rrëzojë. Jam këtu përballë hijes sate, që kërkon të pamundurën e qiellit, e cila mbi ty të qëndrojnë. Kthehu pak, lëre shpinën tënde të më respektojë, drejtoje kokën e kthemi sytë e thellë e të errët plot drunj si të Amazonës së kaftë.

Pasi ta kesh mposhtur luftën brenda teje e të jesh kthyer, tregomë se ç’sheh, mos është vallë një stol i varrë nga lagështia dhe i ngrënë nga bora e shiu?

Sigurisht që ai stol është, por jam edhe unë që ta dish!

Qëndroj në mes të stolit, aty ku probabiliteti për të rënë është i lartë, sepse stoli është i thyer në këtë pikë, ku është më e lehtë të të kem përballë, të t’i shoh sytë e mëdhenj e të lartë, madje duke e ditur që ata sy nuk ulen asnjëherë poshtë për të parë se kush qëndron mbi stolin e zi.

Unë kam një trajtë i dashur, jam e ulur këmbëkryq me dhimbjen në shpirt, me dy sy që të zhbirojnë ty botën e brendshme e lumenjtë, të cilët burojnë nga ti, kam një zë që kur flas i bën njerëzit t’i adhurojnë fjalët e mia, por mbi të gjitha unë kam një shpirt që s’e di nëse do të më bëjë të ndihem ndonjëherë e lumtur me atë që unë portretizoj si njeri.

Ndonjëherë më duket sikur jam kornizë tek ti, mbuloj konturet e tua, të skalis defektet dhe kurrë askush nuk tha: “Ajo pikturë e meriton atë kornizë të re”, por të gjithë rendën të planifikonin blerjen e një kornize të re, në rast se do të dilja jashtë mode. S’do të doja ta besoja kurrë këtë iluzion ogurzi, sepse unë ta kam prekur shpirtin para se të ta ketë prekur dhe më e madhja jotja dashuri.

Shpeshherë ngrohtësia jote lunare më lëndon, më dukesh si një përrua, ujërat e të cilit lakmohen nga çdo shtrat i shtruar me gurë, që ti has në rrugët e përditshmërisë, e dreqi ta hajë kjo më vret, madje aq shumë sa prirem të zhdukem e mos t’i lëshoj më kurrë sytë e mi të errët mbi tënden larmishmëri.

Te ky stol tani, me fuqinë therëse të erës, e cila përpiqet të më shkulë zemrën e të më largojë, dua të më shikosh, të më buzëqeshësh e mos më lësh të shkoj. Mbi trupin tim të bërë akullnajë duke të të pritur, dua të më vesh dorën në shpinë, e të më hapësh dyert e ngrohta për tek ti, ku të më thërrasësh në mënyrën që vetëm një zemër e dashuruar di ta pëshpëritë.

Thuaje! Bërtite këtë iluzion dhe thyjeji barrierat e qiellit të akullt, që shtrihet midis nesh.

Por jo, ti nuk do ta bësh, as unë nuk do ta ndiej, sepse ti nuk mund ta shohësh hijen mbi stol, e kush mundet vallë?!

Muzgu u thye për t’i lënë vendin kësaj mbrëmjeje, që duke rënë mbi qytet përfshiu edhe lagjen e stolit, ku nuk gjendet asnjë dritë të më ndriçojë nën sytë e tu, mirëpo as ti s’e ktheve kurrë kokën të më kërkoje në errësirë.

Ashtu siç ishe, me fytyrën nga qyteti të dëgjova tek pëshpërite me pakëz zë EJA dhe një lot nga të mitë sy ra, sepse ajo fjali s’më drejtohej mua, hijes që fshihej mbas stolit prej dru lisi. Ne mbetëm të dy, unë tek ti dhe ti tek unë, vetëm se në fund se di nëse rashë unë apo re ti, apo ramë të dy atë mbrëmje mbi stolin e kodrës. Ti the eja, ndërsa unë sërish u fsheha nga pas, sepse unë jam hije i dashur ndaj t’i s’mund të më shikosh, unë jam puthje mëngjesi, që asnjëherë s’e ndien kur ta dhurojnë.

Romani “Dashuritë e virgjërshës Madalenë” i Ridvan Dibrës

“HIMENI” I GRUAS SI “VRIMË E ZEZË” E NJERËZIMIT

Nga Ballsor Hoxha



Ka një lojë dhe paradoks qysh në titullin e romanit Dashuritë e virgjërshës Madalenë: derisa ne të gjithë paramendojmë një përdalje dhe një Hari Mata Hari në Madalenën e titullit, mirëpo vetë titulli në të vërtetë na bën me dije se bëhet fjalë për një virgjërshë, e në këtë edhe se nuk ka ndonjë dashuri brenda po të njëjtës, së paku të llojit të cilin e nënkuptojmë nga ky titull! Gjë që qysh në fillim fillon lojën e shënimit të kuptimit, ndërmjet asaj që presim dhe asaj që është në të vërtetë, lojë e cila na bën me dije se në fund ka vetëm shënjim dhe ai bartet pavarësisht tekstit fizik dhe pavarësisht qëllimit të tij.

Paradoksi i radhës në romanin e autorit Ridvan Dibra “Dashuritë e virgjërshës Madalenë” fillon me uzurpimin e hapësirës letrare të autorit nga personazhja e tij, me rrëfimin e saj. Në të vërtetë ajo e krahason dhe e kundërshton rrëfimin e vetë autorit nga një vepër tjetër për vetë personazhen. Kjo duke krijuar hapësirën e quajtur – difference – të teorisë së Dekonstruksionit, e që është hapësirë e mospërputhjes së përhershme të shënimit, shënjimi duke qenë i përhershëm dhe i pandalshëm i cili gjithnjë ikë nga kuptimi i vendosur.

Në të vërtetë ky paradoks është – çarja – (difference e Dekonstruksionit) të pushtetit të autorit, duke krijuar një hapësirë të re, të rrëfimit dhe me këtë të atashimit dhe të shënimit të këtij teksti. Kështu

duke na dalë disa shtresa, disa korniza të rrëfimit të këtij teksti.

Romani Dashuritë e virgjërshës Madalenë është tekst i cili shtrinë përmbajtjen e tij rreth gruas, vajzës dhe femrës, jetën e saj të projektuar që prej statistikave globale e deri tek mësueset. Është, në sipërfaqësoren e tij, roman kritikë ndaj paramendimit dhe modelimit që i bëjmë secilës grua në secilën pamje dhe situatë.

Teksti ka tri thyerje, të triat lidhur me qendër: himenin/virgjërinë si – hata -. Derisa dashuria nën shënjimin e po të njëjtës del e pakuptuar dhe a panjohur nga ne. Aq më shumë që ajo më kompleksja në mes këtyre dyjave, zhvirgjërimi, del si një “vrimë e zezë” e njerëzimit në të cilën është përpirë njeriu.

Në të vërtetë, të tria këto janë shënime për gruan dhe në këtë difference, apo himenin, - çarjen - e të vërtetës mbi gruan, të vetë asaj që teoria e dekonstruksionit e njeh si – undecidability – (Pavendosmëria). Ky term përndryshe dhe në të vërtetë, është i lidhur me shembullin direkt të Himenit të gruas. Sipas teorisë së dekonstruksionit, derisa himeni është edhe i munguar e edhe prezent, apo asnjëra; apo është as e jashtëmja as e brendshmeja e trupit, apo të dyja; ai krijon pikërisht – pavendosmërinë – e kuptimit njerëzor. Ai si fenomen fizik/inegzistent del si paradoks i tërë filozofisë që nga Aristoteli, duke qenë

se logjika nuk e pranon një gjë që edhe të jetë edhe të mos jetë në të njëjtën kohë. Gjë që do të thotë se – pavendosmëria – është ajo hapësira ndërmjet të vërtetës, një e vërtetë e – pavendosur – e cila qëndron me gjithë dallimin dhe ndryshimin dhe mospërbushjen e të vërtetës e cila e përkufizon.

Kështu teksti i romanit “Dashuritë e virgjërshës Madalenë” për të hapur/çarë këtë pavendosmëri të të vërtetës mbi gruan, së pari krijon qendrën e tij, dhe që është pikërisht dhe me qëllim autorial, si në teorinë e dekonstruksionit, vetë himeni i personazhit “virgjërshës”.

Himeni i personazhit “virgjërshës Madalenë” si qendra e tekstit të autorit Ridvan Dibra, është shënjimi që shkakton thyerjet e narrativit dhe komplekset e jetës dhe të përvojës. Të gjitha rrënohen, ngritën dhe rrënohen në jetën e “virgjërshës” me qendrën – himenin - e saj.

Qendra e romanit gjithherë është momenti, apo edhe baza ku – çahet – kuptimi, ku shënjimi ikë nga kuptimi në shënjimin e radhës. Në këtë – himeni i virgjërshës – si shënjim i një kënaqësie, jot vetëm të saj, dashnorëve të saj, por edhe të lexuesit, gjithnjë në paramendim, në pritje dhe në nënkuptim, bëhet fiksimi i shënimit, por, duke iu kthyer asaj që morr shembull me titullin e këtij romanit, ai gjithnjë ikë në një kuptim të ri.

Kjo qendër e Himenit, që në të vërtetë del edhe e jashtëmja edhe e brendshmeja e një gruaje, të shënimit të tekstit të romanit Dashuritë e virgjërshës Madalenë, është i ndërtuar në tri periudha, tri – çarje – dhe tri kulminacione të përvojës së personazhit kryesor “virgjërshës”.

Kulminacioni/thyerja, apo ekzistenca/mosekzistenca e himenit të saj, apo e jashtëmja/e brendshmeja e çarë e jetës së saj, shfaqet në 15 vjetorin e “virgjërshës” me – himenin – e saj në pritje për zhvirgjërim. Në ankthin për zhvirgjërim, në bartjen dhe projektimin e zhvirgjërimit të saj nga statistikave, shoqet e shoqëria në tërësi. Ajo/ai, himeni, edhe zhvirgjërohet, pa asnjë romantikë, pa asnjë kënaqësi, avanturë apo perversitet apo edhe premtim. Ai është një neveri i cili kalon në shënjim të tërë raportit mashkull femër për “virgjërshën”.

Mirëpo teksti – çanë – tërë kompleksin adoleshent të virgjërisë/zhvirgjërimit femëror në perspektivën e adoleshenteve, duke shënjuar zhvirgjërimin si mjet për të arritur pushtetin mbi “botën e të madhit”. Në të vërtetë derisa të gjitha shoqet e saj mburren për jetën e tyre seksuale dhe e marrin për dele të zezë “virgjërshën” ajo shtyhet po nga kjo për të kryer aktin e zhvirgjërimit pa asnjë dashuri dhe asnjë plan apo edhe atashim, dhe atë pikërisht në “tualetin më të pistë të shkollës” së saj. Dhe pikërisht kur e ka kryer këtë akt, kupton se është e vetmja e cila është zhvirgjëruar. Gjë që krijon shënjimin e ekzistencës/mosekzistencës së himenit, dhe të të brendshmes/të jashtëmes së jetës së saj të pa qenë dhe të qenë në të njëjtën kohë.

Guximi i saj për të përkur, për të marrë pjesë në botën e përvojës, të të madhit, me zhvirgjërimin e saj, krijon shtresën e parë të qendrës së tekstit duke e krijuar bazën e narrativit rreth himenit të saj, si shënjim i “vrimës së zezë” të shoqërisë ku jeton “virgjërshja”.



RIDVAN DIBRA

*Dashuritë
e virgjërshës
Madalenë*



OnufriRoman

Kulminacioni/thyerja, e brendshmja/e jashtmjaja si shtresë e dytë e qendrës së tekstit të romanit të Ridvan Dibrës, shfaqet, në 25 vjetorin, ditëlindjen e jetës së “virgjëreshës”. Në këtë me himenin e saj “vënë myk” nën neverinë e zhvirgjërimit, në neverinë që i ka shkaktuar zhvirgjërimi dhjetë vite më herët.

E brendshmja/e jashtmjaja e saj, mosqenia dhe qenia e saj është tërësisht e lidhur po ashtu edhe në këtë periudhë, me himenin e saj. “Virgjëresha” krijon më në fund një lidhje romantike, dhe në tërë romantikën e dashurisë i jepet partnerit të saj, në bisedë, duke i treguar tërë historinë e saj të “tualetit më të pistë të shkollës”. Dhe është pikërisht kjo që e kthen atë në pikën zero të himenit/trupit/shpirtit të saj, duke qenë se partneri i saj, i cili në tekst martohet me shoqen e saj, po ashtu të zhvirgjëruar, e dëbon “virgjëreshën” me arsyen se nuk është e virgjër.

Himeni i “virgjëreshës” në këtë është prapë e brendshmja/e jashtmjaja e saj, në shënjimin e mungesës së dashurisë, mosnjohjes së dashurisë, dhe të panjohurisë mbi dashurinë. Por kjo duke qenë gjithherë e jashtmjaja e cila duhet mbajtur nën pushtetin e burrit përmes virgjërisë, dhe e brendshmja e saj duke qenë gjithherë e shënjuar nga himeni i saj.

Kjo duke krijuar shtresën e dytë të qendrës së tekstit, që do të thotë se shoqëria thellohet më tutje në himenin e “virgjëreshës” duke qenë se është i vetmi shënjim, i vetmi kuptim i dashurisë. Shoqëria thellohet edhe më tutje në “vrëmën e zezë” të himenit të “virgjëreshës” duke e përmbysur çdo shënjim të dashurisë për shënjimin e himenit të saj, si nënshtrim.

Shtresa e tretë dhe e fundit, e cila e rikthen shënjimin e tërë tekstit pikërisht në himenin e “virgjëreshës” dhe po ashtu shënjimin në lexuesin në pritjen e tij dhe në premtimin që e ka thurur ai/ajo për këtë tekst, është shtresa ku personazhi i “virgjëreshës” arrin 40 vjetorin e saj.

Tanimë ajo e mësuar me neverinë e mashkullit në raport me atë, e mësuar edhe të masturbojë e edhe të manipulojë, është në kërkim të lindjes së një fëmije dhe për këtë është e gatshme edhe të sakrifikojë mbi neverinë e saj për meshkuj, por gjithsesi me kuletë të mbushur. Mirëpo pikërisht në dyzetvjetorin e saj, ajo arrin të kuptoj, dhe për fat të keq me partnerin e saj seksual, se vetëm aty dhe në dyzet vjetët e saj është duke e humbur virgjërinë. Gjë, që shkon edhe më tutje, e ndanë atë nga partneri i saj, pikërisht në kundërshtim me refuzimin që pëson në Dashurinë e saj në 25 vjetorin e saj, e që është për shkak të të qenit e virgjër.

Prandaj qendra e tekstit, dhe me këtë shënjimi i shoqërisë dhe vetë gruas dhe përvojës së saj në shoqëri, është e ndërtuar me himenin e personazhit “virgjëreshës” në qendër.

Himeni i saj asnjëherë nuk ka ekzistuar, dhe ai gjithherë ka qenë aty, deri në fund. Himeni i saj asnjëherë nuk ka qenë e jashtmjaja e jetës së saj, si pushtet, apo përvojë apo arritje, dhe ai në të vërtetë gjithnjë ka qenë në të kundërtën, si ikje prej tij, shënjimi i arritjes së saj. Himeni i saj kurrë nuk është zhvirgjëruar në të vërtetë dhe gjithherë ka qenë problemi i saj si zhvirgjërim, dhe në të kundërtën, ai ka qenë i zhvirgjëruar qysh në fillim dhe gjithherë ka qenë i virgjër. Thënë shkurt ajo arrin suksesin e saj në neveri ndaj himenit të saj, dhe himeni i saj është vetë përqendrimi i tërë shoqërisë ku ajo jeton, e ai kurrë nuk ka qenë, dhe ai në të vërtetë gjithherë ka qenë aty.

Pikërisht kjo është – pavendosmëria – e të vërtetës e cila e – çanë – shoqërinë njerëzore në të vërtetën/të vërtetat e saj të përhershme. Gruaja me himenin e saj si “vrëmë e zezë” e kuptimit njerëzor. Qoftë për veten e saj, dhe qoftë për tjetrin. Në të vërtetë, e vërteta e shoqërisë duke u dekonstruktuar në një himen i cili bën të jashtme jetën e gruas, dhe në të njëjtën kohë krijon tërë të brendshmen e gruas. Himeni i gruas duke qenë edhe e vërteta e gruas dhe mbi gruan, por sidomos edhe e vërteta e mashkullit dhe tjetrit për dhe mbi veten. Himeni i gruas duke qenë edhe dobësia e saj më e madhe, në kuptimin e të qenit e gjykuar në bazë të tij, si edhe pushteti i saj mbi tjetrin.

PANTEONI I QYTETËRIMIT QË ECËN

CIKLI I BERATIT

Poezi nga Nazif Agalliu

BERATI

Opidum parthinorum

Qytet i kahershëm
Qiej të vjetër
Kanionet e gjurmëve të gjuhës
Ndriçojnë ikonat e qëndresës

Në gjymtyrët e shekujve
Kodiku i Artë e i Purpurt
Batica e imazheve
Fshin diskurset

Labirinti i dialogut
Çngjiz semantikën parake
Mbi shtatë kulmoret
Hapen arshivat pagane

Në sfondin e epërm solid
Të një magjie afresku
Identiteti mahnitës i çudive
Legjitimon një perlë të UNESCO-s

BERATINUS

Partha Albanorum Opidum

Fortesa ilire e bardhë
Me petale urbane të sotme
Pezulet e gurta dritaret
Me çkodifikim shqipfolës

Ekologjia humane
Me ligjësi ekzistence
Morfologjia e peisazheve
Shpirtin e formës përcjell

Struktura një lokus unik
Tipologji racionale parake
Me elementë alegorikë
Simbolet e ritualet

Shtëpitë pa mure ndarës
Nyjet urbane që ecin
Identitetet përflasin
Modernizim e mosprekje

EMBLEMAT

Si një urë e varur
Qyteti lëkundet
Në jehonat e minareve
E koret e lutjeve në kulte
Kohë mbretërisht ilirë bujarë
Kohë me kurorë anzhuine
Kohë bizante e mjegullt
Kohë e sufikseve sllave
Kohë mugujgjatë osmane
Kohë me gjak e tulipanë
Koha e qëndresës së Arbërve
Kohë invazionesh barbare
Kohë erozionesh botërore
Në lëngatën e gjatë të plagëve
Mosasimilim emblema e Beratit
Qyteti i bardhë
Me dekoracion anjëanës

BANORËT

Aspak të çuditshëm
Të mirëfilltë
Dialogojnë me mjegullat
E lënë diellin të lindë

E lënë lumin të rrjedhë
Ngjiten e zbresin në kujtesë

Mëkateve e kulteve u druhen
Përulen si një fije bari
Si tel i butë e s’këputen

Bashkëjetojnë si në gojëdhëna
U shkojnë gjërave në fund
Herë herë mbesin në fundin e gjërave

FORTESA

Castrum munitum situ natyrali

E fortë në natyrën e mjedisit
Themele të hershëm
Mure legjendash. Gurë ciklopikë.
Mbi një shkëmb të bardhë
Një shkëmb të thepisur
I zgjatet si dorë yllit të erës
Si një hark triumfi kalëron humnerën
Formën e kodrës modelojnë muret
Në tejanë një trekëndësh brinjëlakuar
Një kult kulmi
Një Panteon mijëvjeçar
Brinjë konkave brinjë konvekse
Djep i lindjes së Helenës
Nënës princeshë të Konstandinit të Madh
Racës së ilirëve
Më të rëndë se gurët
Në fortesë arkivat

QYTETI ILIRIK

Qytet i begatë
Iliriku i bardhë
Me diellin bujar te Tomorit
Me erën e ftohtë frymë akull e brymë
Shtrati bashkëshortor i diellit
Në Albanoi lulëzove
Ti krenaria e Ilirikut

APSUS
Apsus is called Beratino
Puoquevillo

Lind në fleksionin e borës e akujve
Përmbysur qiej e male
Në Apsus predikon e falet pelegrini Shën Pal
Në shekullin e parë
Në Apsus piu Ujin e Mirë e Apsusin piu me sy
Hëna e dielli udhëtojnë mbi harqet e gurtë të urave
Njëherë jam larë në të njëjtat ujëra
Njëherë aty jam mbytur
Apsus i kaltër i cekët i thellë
Të mbyt e të nxjerr
Erë jugu sjell, perëndimit i qepet
S’e gjen prehjen në det
Një tjetër shtrati shpirtin i jep

NË KËRKIM TË KOKËS SË HUMBUR

Meditimi i një statuje pa kokë

Nga POL MILO*

“Pashë një engjell në mermer dhe e gdhënda derisa e çlirova...”
Mikelanxhelo

*Ne kemi lindur për të humbur
Pjesa më e mirë lind për të humbur
Koka ime u krijua për të humbur*



Jam një statujë. Statujë pa kokë. Trupi im shkëlqen. Kurse kokë nuk kam. E humba komunikimin me kokën time qëkur ma prenë. Për të menduar koka nuk më duhet. Të tjerë merren me mua. Ata kanë pastruar trupin tim nga pluhuri dhe me një mbishkrim, më kanë vendosur në qendër të holli i një muzeu, me ndriçim të theksuar nga drita neonësh. Në mbishkrim shkruhet qartë që unë i përkas shekullit të dytë para erës sonë. Pasi më zhvarrosën, më vunë këtu.

Por ato s'dinë asgjë mbi mua. Nuk i dinë majat e daltës që më gdhendën, as duart e skulptorit që e goditën daltën me forcë, me një çekan të madh. Duart e tij ishin të rënda dhe gishtat e trashë. Më krijoi nga një copë mermeri që e nxorën nga brendësia e një mali. Unë i përkas tokës. Çfarëdo forme të më japin, unë i përkas asaj.

Format artistike lëvizin, krijohen nga frymëzimet e artistit, ekspozohen, komentohen, rikrijohen e më pas humbasin. Kështu humbi edhe koka ime. Njësoj, siç humbën edhe shumë koka të tjera si ajo. Dikush tha që i vodhën, i këputën, i prishën, i shitën, në vende të ndryshme, në qytete të mëdha. Trupat i ekspozuan diku, kokat diku tjetër. Mbi trupa shënohet diçka, mbi koka diçka tjetër. Po çfarë forme kishte koka ime? Ku e dinë ata? Çfarë mbishkrimi kisha fillimisht? Cilën perëndi përfaqësoja? Çfarë dënimi më dhanë? Ç'gjyqinë përdorën?

Tani kam tjetër mbishkrim në trup e tjetër mbi kokë. A thua se koka dhe trupi im nuk u krijuan njëkohësisht, nga e njëjta dorë, nga i njëjti skulptor, nga i njëjti mermer, nga i njëjti mal, nga e njëjta tokë. U gdhendën nga e njëjta daltë e u goditën nga i njëjti çekan. Po ju që dini formën e mendimit tim, a mund të më thoni se ç'formë kishte koka ime?

Interpretimet janë të ndryshme, interpretimet pëlqejnë komente të tjera. Ato as që i afrohen sado pak idesë qendrore. Me kalimin e kohës ato humbasin. Kuptimi humbet. Krijimi humbet. Ngelin vetëm copa-copa, të padeshifrueshme.

Piramadat janë të padeshifrueshme, kalatë janë të padeshifrueshme,

kullat, torrat, muret janë të padeshifrueshëm. Papirusët, mumjet, sfinksët janë të padeshifrueshëm. Ata mbajnë kode, informacione që askush nuk e di plotësisht kuptimin e tyre. Nga erdhën, si u krijuan, përse u krijuan?

Njerëzimi ka ujitur ulla me degët e të cilëve ka vendosur kurora mbi kokat e njerëzve. Po me cilën degë ulliri u thur kurora ime? Në cilët tempuj u vendos? Cilët adhures u përlulën përpara saj, në kërkim të mëshirimit qielor, që unë dikur e paskam zotëruar?

Tempujt gjithashtu janë të mistershëm, të padeshifrueshëm, njësoj si statujat. Si statujat pa kokë. Njësoj si unë. Ne kemi lindur për të humbur. Pjesa më e mirë lind për të humbur. Koka ime u krijua për të humbur.

Nëse mbi tokë nuk do të kishin humbur kokat e dinozaurëve, nuk do të kishin humbur as kokat e statujave. Sa mirë do të kishte qenë sikur pranë meje këtu të ishin edhe disa kocka dinozaurësh. Por edhe ato humbën.

Kjo tokë është humbësja më e madhe që ne njohim. Ajo humb fakte dhe ngjarje, vepra dhe kryevepra, të çmuara e artistike. Dhe kur i humb, ajo e ka vendosur që të mos i kthejë më.

Ajo i mban ato për vete siç mban shumë kryevepra të tjera. Çdo kokë e humbur është një sfidë, një shënim, një mbishkrim, një përkthim apo interpretim tjetër, herë i ngjashëm dhe herë pa lidhje me stilin, me artin, me kuptimin e hershëm.


Tani lindin kuptime të reja, dhe vdesin kuptime të vjetra. Heshtja dhe pluhuri zëvendohet nga zhurma dhe pakuptueshmëria. Më pas, pakuptueshmëria kthehet në objekt, në stil, në mënyrë jetese. Njësoj si trupi im që kthehet në objekt pa kokë. Kurse koka ime as që e çan kokën për mua. Ajo humbet nëndhe ose qëndron mbi një trup tjetër apo shkëlqen në vetrata të ndriçuara me drita neonësh. Me një tjetër mbishkrim.

Ndërkohë unë humbas kuptimin. Unë nuk e dëshirova shkëlqimin tim.

Shkëlqimin e trupit tim. Kuptimi u zhduk, pikërisht ai që mua mu donte. Ndërsa trupin tim tani e adhurojnë vizitorë të paditur, lexuar në mbishkrime të pakuptimta, që aludojnë se më përkasin mua, të vendosura nga autoritete të çuditshme, të pafuqishme për të risjellë atë që unë kërkoj. Ju lutem, aludoni për kokën time dhe jo mbi trupin tim. Ndaj sillmëni atë që më detyroheni. Kokën time!

Dyrrachium, brigjeve
Maj 2021

**Pol Milo ka mbaruar studimet
e larta në Romë, për ekonomi.
Është autor i librit “Shtegtimi i
dinozaurëve fluturues”*



Mbresë rreth romanit “Extra time” të shkrimtarit Durim Taçi,
shkruar në vetën e dytë.

KOHA SHITESË NË 7 VJET E 7 DITË

Nga Visar Zhiti

“Extra time” më erdhi si një befasi me të gjitha kuptimet. Dhe i tillë është, arrin të të gjejë dhe të godet, si era mbase e të trondit si një tërmet, pa zhurmë, por I heshtur.

Se jeta kështu është, dhimbja e saj ashtu si dhe ngazëllimet, e zakonshmja dhe e pazakonshmja, etj, etj, duan dhe një sendërtim të dytë, për t’u kuptuar më mirë dhe jo vetëm kaq, për t’u ndjerë e ty të duhet ta ndalësh kohën, më saktë ta krijosh, ta rikrijosh ende më saktë, jo perjetesinë e pamundur, por të përhershmen, një të gjithmontë tonën.

Libri, besoj, mbetet më i përshtatshmi për ta mbartur rrjedhën e jetës si një pranë, ëndërr dhe mister bashkë, ku e pritura dhe e papritura ngatërrohen mes tyre, shkëmbejnë dhe vendet ose kapitujt. I tillë është dhe libri yt, aq shumë filmik, sa më shumë ngjan se shikohet se sa lexohet. Dhe ashtu siç ti kërkon një “extra time” - kohë shtesë rrëfimi, kështu do të duheshin dhe “extra words” për të rrefyer rrëfimin, fjalë shtesë që s’janë shpikur ende dhe ti ke nxjerrë shpirt nga fjala, pa i kërkuar ato, janë fjalë të përditëshme tonat, a u ke dhënë shpirt të ri a nga Qielli ka rrjedhur ajo frymë prej Ati a të gjitha bashkë a diçka tjetër e përtejme, një si ndihmë

prej Hyu a të gjitha ishin këtu, Brenda nesh.

Libri yt përjetohet, ritmi i tij është puls i gjallë, si një ecje e nxituar e atij që nuk ka kohë ta thotë kumtin e vet më të rëndësishëm, por që duhet thënë patjetër, shenjat e tij do të donin të kundërshtonin harrimin dhe ti ia del ta pakësosh atë, duke hequr të tepërtat, siç thoshte Mikelanxhelo për statujën, por duke vënë të tepërtën, jo që të përftohet një statujë, por jetë e jetës.

Të teorizosh si kritikët e të thuash që është pasqyrë e një realiteti, jo, nuk ke për të qenë i saktë, I them vetes, as të shtosh se është një realitet tjetër paralel letrar, gabim, prapë I them vetes, por vërtet “Extra time” është një të jetuar tjetër, si zanafillor, me magjinë e leximit, real si ai i përjetuari që s’lejohej të bëhet kujtim, i shpalosur në një një tashmë autoritare, të filtruar natyrisht, se ti je shkrimtari, me atë teknologji që bëhet lënda e së përhershmes, (gjuhësisht koha e tashme e përhershme duhet krijuar medoemos), që s’është një dimension sipas logjikës së varfër të njerëzve, por vërshim njëherësh e-shkuar-e-tashme-e-ardhme-bashkë, duke i bërë një çarje çesariane barkut të Kronosit, Ky është libri yt, një risi në letrat shqipe, sipas meje. Në fund të



fundit ai është një rrefim në altarin e vetes, një e folur me vete, nga një tronditje supreme, ndërkaq e mbajtur 7 vjet brenda vetes dhe e zbrazur për 7 ditë si në një mit, prandaj dhe libri me të drejtë mund të quhet dhe mitobiografi, duke iu larguar vetes, si shpirti që kërkon të na ngrihet lart, për të na kqyrur me një mosfolje të shenjtë.

Shkrimtari e thyen këtë pakt nga shkaku i demonit të tij të brendshëm, ti flet dhe s’e ka për gjë t’i rrefehesh vegimeve ashtu si dhe një ikone, apo urës, bregut pranë shtëpisë, agut, ashensorit, që pasi hap dyert, nuk sjell atë që duam dhe e nis sërish, të vijë me ëndrrën e asaj që duam.

Shkrimtari i jep zë të heshtur fletës së shkrimit në kompjuter, të kaltër si një copë parajsore qielli dhe studion e krijimit e bën fushë futbollit, ku luajnë jeta me vdekjen, me arbiter fatin. Që pas lojës janë bashkë. E kush fitoi?

Po kjo është lojë, pa fitues të vërtetë dhe humbës të vërtetë dhe Zoti e di ku është e vërteta, si e qysh. E bukur dhe frikshme! Dikur, thua ti. Dhe dikur është dhe nesër, Ti mundohesh t’i bashkosh si në një tashme. Dhuratë për fëmijët. Dhe djemtë tanë fatalisht deshëm të ishin dhe etërit tanë. Sa gabim dhe ç’dhimbje pa fund që na dëgjuan...


Dhe s’na mbeti gjë tjetër veçse t’i japim dinjitetin e merituar dhe vdekjes ashtu si jetës.

Durim Taçi, me këtë libër ia ke arritur, shkëlqyer mynxyrshëm a mynxyrshëm shkëlqyer a... duhen *extra words*. Di që nuk është libër-britmë, as *requiem* dritë-mugët. Është një vetvete e dytë, jo vetëm jotja. Dhe s’kish si të ishte ndryshe...

Asaj i drejtohesh, vetvetes si tjetrit, njëlloj si botës, s’ke ç’i bën emfazës, është si pandemia, aqkollajrënëse, nuk është e veprës tënde, realiteti vërtet është habitës, antilogjik, ndërkaq i druhash emocioneve të tua, që t’i tregosh dua të them, por jo poezisë së fshehtë, dhe tregon ato dhe aq, që të mundin të shkaktojnë emocion te leximtari, te tjetri, te vetja tjetër.

Në fund të fundit qëllimi yt më duket se është shumë më konkret, se edhe :endrra është konkrete, edhe deliri, edhe krijimi, konkretja s’është dhe aq konkrete, ti do që Atisi yt, ashtu si birin e mitologjisë që Zeusi deshi ta ringjallë, qoftë dhe pjesërisht, ta risjellësh, të dashur dhe të bukur, sportist në fushën e jetës.

Prandaj dhe ashensori i librit, kur i mbyll në funt fletët e veta, shohim se e ka nxjerrë atë dhe po vjen drejt nesh.



RADHA

*Tregim nga
Jo Nesbø*

Unë i urrej njerëzit që futen pa radhë.

Sigurisht që kështu është, sepse një pjesë të mirë të jetës sime tridhjetë e nëntë vjeçare e kam kaluar nëpër radha.

Pavarësisht se në dyqanin ku punoj, 7-Eleven, ndodhen vetëm dy klientë, dhe gruaja e moshur ngalet ta nxjerrë portofolin, unë i hedh një shikim të ftohtë djaloshtit që i ka marrë radhën asaj. Ai ka veshur një xhup që unë e di mirë se është i markës Moncler ngaqë syri diku ma ka kapur një të tillë; menjëherë kam arritur në përfundimin se kurrë nuk do ta kem mundësinë ekonomike për ta blerë një xhup si ai. Pallton që bleva te Fretex-i para se të hynte dimri, e kam mjaft të mirë. Megjithatë, erën e personit që dikur mbante veshur këtë xhup, patjetër ndonjë tip si ky që është futur pa radhë, nuk kam mundur ta largoj.

Ndodh shumë rallë që njerëzit të futen pa radhë në dyqanin tim, duke përfshirur këtu netët kur ata janë të pirë; njerëzit janë tepër të sjellshëm në këtë vend. Hera e fundit që ndodhi diçka e ngjashme, qartë dhe në mes të ditës, ishte para dy muajsh. Një grua e rritur, e veshur me shumë stil, ma mohoi kur ia vura në dukje se ajo ishte futur pa radhë, për më tepër më kërcënoi se do të fliste me shefin e madje do të kërkonte që të më pushonin nga puna.

Shikimi i djaloshtit has shikimin tim. Sytë e mi kapin një buzëqeshje të lehtë në fytyrën e tij. Ai është pa turp. Madje edhe pa maskë.

‘Kam për të marrë vetëm një kuti burnoti General,’ thotë ai, a thua se kjo justifikon futjen e tij pa radhë.

‘Ti ke për të pritur në radhë,’ them unë pa e hequr maskën e fytyrës.

‘Prapa shpinës e ke, vetëm pesë sekonda duhen.’ Ai tregon me gisht kutinë e burnotit.

‘Ti ke për të pritur në radhë.’

‘Sikur të ma kishe dhënë kutinë, tani do të isha jashtë dyqanit.’

‘Ti ke për të pritur në radhë.’

‘Ti ke për të pritur në radhë,’ më imiton ai duke ekzagjeruar theksin tim. ‘Hë de, bushtër.’

‘Ai buzëqesh edhe më shumë, sikur e gjitha kjo të jetë një shaka. Ka gjasë që ai të mendojë se mund të më flasë në këtë mënyrë meqë unë jam grua dhe që i përkas një kategorie punonjësish me rrogë të ulët, refugjate me një ngjyrë lëkure të ndryshme nga lëkura e tij e bardhë. Ka gjasë që ai t’i ketë huazuar këto nga një gjuhë fisnore, të cilën beson se e flas edhe unë. Ndoshta është ironik dhe luan këtu parodinë e një djali të keq. Pasi ia hedh shikimin edhe një herë nga afër, alternativën e fundit nuk e marr në konsideratë; ai është njeri i cekët.

‘Largohu që këtej,’ i them unë.

‘Më duhet ta kap metronë. Hë pra.’

‘Do të kishte qenë më mirë sikur të kishe pyetur atë që është në radhë përpara teje.’

‘Metroja që do të marr...’

‘Metro këtu ka çdo çast,’ them unë tek dëgjoj hungërimën e vazhdueshme të metrosë që ndodhet dy shkallë më poshtë. Që nga dita kur fillova punën këtu, motra e vogël më pyeti nëse i trembesha terroristëve që përdorin gazin helmues sarin. Gjatë luftës civile, përpara se të largoheshim nga vendi ynë, të gjithë kishim frikë nga ai gaz. Neve na ishte thënë se një sekt terrorist japonez, në vitet nëntëdhjetë, kishte hedhur gaz helmues në metronë e Tokyo-s. Motra ime ishte vetëm nëntë vjeçe, kur i hyri frika në palcë nga gazi helmues në stacionet e metrosë.

‘Në linjën time ka tren çdo pesëmbëdhjetë minuta,’

thotë ai me një tingull fishkëllyes. ‘Më duhet të kap diçka, OK?’

‘Një arsye më tepër se përse duhej të kërkoje leje,’ them unë tek pohoj me kokë në drejtim të zonjës, e cila ka bërë gati portofolin për t’i paguar tre sendet që ndodhen në banak përpara meje. Djaloshi, me hamendje them se është rreth njëzetë e pesë vjeç, stërvitet rregullisht në palestër, merret më shumë me pesha dhe ushtrime force – nuk ka durim, dhe është e sigurt se është në mëdyshje. ‘Tani, lëkurëzezë e rrjedhur!’

Zemra më rreh shumë shpejt, dhe kjo jo aq shumë për shkak të përpjekjes së tij për të më fyer. Unë nuk e di nëse djaloshi është racist apo thjesht po provon të më lëndojë me atë që ai mendon se do të më djegë e do të më provokojë më shumë, siç do të më thërriste xhuxhe po të isha e vogël, ose mjelëse po të isha e bëshme në trup. As që dua t’ia di se çfarë paragjykimesh ka ai, zemra më rreh me shpejtësi ngaqë kam frikë, sepse në mes të dyqanit ndodhet një djalë trupmadh, i cili në harkun kohor të disa sekondave e ka kaluar cakun aq dukshëm, saqë kjo do të thotë se ai ka një sërë problemesh me vetëkontrollin. Unë nuk shikoj ndonjë gjë të pazakontë në beben e syrit apo në gjuhën e trupit të tij që të dëshmojë se ai ka konsumuar lëndë narkotike siç ndodhte shpesh me ushtarët, por sigurisht që këtu mund të jetë fjala për lëndë të tipit steroid anabolik. Ish bashkëshorti im thotë se kjo ndodh ngaqë unë jam kimiste, se kurrë nuk përpiqem ta shpjegojë botën nëpërmjet kimisë, ashtu si edhe në atë proverbin ku dikush që mban një çekik në dorë i sheh të gjitha problemet si gozhda.

Po, unë jam e frikësuar, por më ka qëlluar që të kem qenë edhe më e frikësuar. Jam gjithashtu shumë e inatosur, por ka qëlluar që të kem qenë edhe më shumë e inatosur.

‘Jo,’ them unë me qetësi.

‘Je e sigurt për këtë?’ Ai nxjerr diçka nga xhepi i mirë dhe i ngrohtë i xhupit Moncler.

Është një thikë xhepi në ngjyrë të kuqe i markës Swiss Army. Tehun e thikës e nxjerr jashtë. Jo, ajo është një limë thonjsh. Ai ngre dorën lart dhe ul gishtin e mesit pingul drejt dyshemesë. Më pas fillon t’i limojë thonjtë, ndërkohë që qesh me mua. Njëri nga dhëmbët e tij të parë ka një njollë të zezë. Atë mund ta ketë shkaktuar metamfetamina, e cila përmban tretësira dhe elemente kimike si amoniaku anhidrik e fosfori i kuq që dëmtojnë smaltin. Natyrisht që fajin mund ta ketë edhe një infeksion i rëndë diku në ndonjë dhëmb.

Ai kthehet nga gruaja që ndodhet pas tij. ‘Përsëritet zonjë. ‘E ke problem sikur të psonisja pak?’

Gojëhapur, gruaja shikon me ngulm thikën dhe të lë përshtypjen sikur do të thotë diçka, por nga goja e saj nuk del as edhe një tingull i vetëm. Në vend që të flasë, ajo pohon me kokë me shkathtësinë e një qukapiku dhe dëgjohet sikur ka probleme me frymëmarrjen, ndërkohë që syzet që i mban mbi maskën e fytyrës i vishen me një avull të mjegullt.

Djaloshi kthehet nga unë. ‘A e shikon? Jepi, pra.’

Unë marr frymë thellë. Ndoshta po e nënvleftësoj këtë djalë. Gjithsesi ai është hileqar dhe e di mirë se kamerat e sigurisë në të gjitha dyqanet 7-Eleven regjistrojnë figurën, por jo zërin, kështu që prova të pakundërshtueshme se ai më quajti lëkurëzezë e rrjedhur apo diçka tjetër, si për shembull deklarata raciste që mund të dënohen me ligj, nuk mund të ketë as edhe në sallën e gjyqit. Çështja ndryshon vetëm nëse gruaja e moshuar, e cila qëndron mbrapa tij, dëgjon më mirë nga veshët se ç’mendoj unë. Nuk ekziston ama kurrfarë ligji që të ndëshkojë dikë që lëmon thonjtë me limë.

Tek shqyrtoj situatën, kthej trupin me ngadalësi dhe marr në dorë kutinë me burnot.

Siç e thashë, unë kam qëndruar nëpër radha që nga dita kur linda, dhe të gjitha ato i ruaj në kujtesë. Kam qëndruar në radhë bashkë me mamanë që në moshë të vogël. Radhë te kamionët e OKB-së kur filluan turbullirat e para. Radhë te qendra shëndetësore kur motra ime u diagnostikua me turbekuloz. Radhë te banjat personale në universitet, sepse të tilla nuk kishte për vajzat studente të degës së kimisë. Radhë refugjatësh në dalje të qytetit kur shpërtheu lufta. Radhë për të hipur në anijen për të cilën mamaja kishte shitur gjithçka, vetëm e vetëm që mua dhe motrës sime të na sigurohej një vend aty. Radhë për ushqim në një pikë grumbullimi emigrantësh ku mundësia për t’u përdhunuar apo grabitur ishte përafërsisht po aq e madhe sa në vendin tonë çdo herë që bëhej armëpushim. Radhë dhe pritje për t’u dërguar në një vend të huaj, në një qendër refugjatësh, e cila të jepte shpresë për një jetë më të mirë. Radhë për t’u larguar nga qendra e refugjatëve, për ta gëzuar të drejtën e punës në këtë vend që na priti dhe që unë vërtet e dua. E dua aq shumë sa që të tre fotografitë të cilat i kisha varur mbi shtratin tim në apartamentin e vogël që ndaj me motrën, ishin të çiftit mbretëror. Dy fotografitë e tjera ishin njëra e mamasë dhe tjetra e zonjës Marie Curie, për mua, dy heroina të tjera.

Unë vendos kutinë e burnotit në banak, ndërsa djaloshi mban kartën bankare përballë aparatit lexues elektronik.

Ndërkohë që ne presim që blerja të kryhet dhe të



aprovohet në mënyrë elektronike, unë hap një sirtar në pjesën e brendshme të banakut ku ndodhet një kuti me maska fytyre të papërdorura. Më pas hap shishen e vogël që ndodhet pranë kutisë, dhe tek sjell ndërmend motrën, nxjerr një maskë dhe hedh mbi të një pikë nga përmbajtja e shishes. Dje, ajo hoqi nga muri fotografinë e çiftit mbretëror. Ajo tha se ata ishin futur pa radhë. Një gazetë shkroi se çifti mbretëror tashmë e kishte bërë vaksinën, të cilën pjesa tjetër e popullsisë, po priste për ta bërë. Qeveria i ofroi çiftit mbretëror mundësinë që të hidhej i pari në varkat e shpëtimit, pa dhënë njoftim zyrtar, dhe përpara se të vinte radha e tyre në bazë të rregullave që vlenin për të gjithë popullsinë. Pra, ata e pranuan ofertën. Sidoqoftë, janë dy figura, detyra e vetme e të cilëve është që të jenë simbole dhe ta bashkojnë vendin në rast lufte e krize, persona të cilëve iu është dhënë rasti për t'i përmbushur detyrat në një mënyrë domethënëse: për të qenë shembull për popullin sidomos kur flitet për zbatimin e kërkesave të shtruara nga autoritetet shtetërore për të qenë solidarë, të disiplinuar dhe të durueshëm në pritje të radhës. Megjithatë, mbretërorët, të privilegjuarit, nuk e shfrytëzuan mundësinë që iu dha. Ata shfrytëzuan rastin për t'u futur jashtë radhe. E pyeta motrën nëse nuk do të kishte vepruar edhe ajo në të njëjtën mënyrë. Ajo u shpreh se do të kishte bërë të njëjtën gjë, por shtoi se kapiteni i anijes nuk ishte ajo. Unë thashë se ndoshta mbretërorët kishin vepruar kështu për të dalë në vijën e parë si shembull, për t'i treguar popullit se ta bëje vaksinën ishte diçka e sigurt. Përgjigjja e motrës ishte se unë isha naive, se shfajësimi i tyre ishte i njëjtë me atë që kërkoi kapiteni algjerian kur u mbyt anija e refugjatëve, dhe kur ai vetë u hodh i pari në varkën e shpëtimit.

Aparati elektronik tregon se blerja është aprovuar.

Unë nxjerr maskën e fytyrës nga sirtari dhe ia kaloj djaloshit në dorë.

Tek fut kutinë e burnotit në xhepin e xhaketës, ai më vështron me ngulm dhe i hutuar.

‘Kjo të duhet për në tren,’ i them unë. ‘Tani, maska është me detyrim.’

‘Unë nuk kam kohë për...’

‘E ke falas.’

Djaloshi qesh me përbuzje, rrëmben maskën dhe largohet me rend.

‘Atëherë, në dyqan kemi mbetur vetëm ne të dyja.’

Kur unë mbyllem brenda në garsonierën tonë, ora është afërsisht njëmbëdhjetë e natës. Bën shumë ftohtë, sepse sistemin e ngrohjes unë e ndez vetëm natën, kur ndodhem në shtëpi, ngaqë rryma elektrike është më e lirë atëherë.

Jam e lodhur, drita nuk ndez, hap vetëm televizorin e vogël me volumin e zërit të ulur pothuajse në minimum. Motrën nuk e shquaj dot, ajo është ulur në një qoshe të errët, zëri i saj mbush dhomën. Ajo thotë se vendi i punës paraqet rreziqe për mua. Thotë gjithashtu se para dy muajsh, një grua humbi jetën në tren, se në gjakun e saj u gjetën gjurmë të një lloj organofosfati, i cili përdoret në insekticide dhe që nuk është fort i ndryshëm nga sarini. Ajo shton se e njëjta gjë ka ndodhur tani me një djalë. Motra ime tregon me gisht ekranin e televizorit ku një lexues lajmesh, me një pamje tepër serioze, shikon nga kamera.

Ndërsa dëgjoj mendimet e hallakatura të motrës, unë gatuaq, që do të thotë se ngroh ushqimin e mbetur nga një ditë më parë. Për motrën nuk përgatis asgjë, ajo nuk ka ngrënë si njeri normal që kur ishte dhjetë vjeçe, dhe më kot ka pritur në radhë për kurimin e premtuar bashkë me pacientë të tjerë të sëmurë me turbekuloz. Vitin e kaluar, në të gjithë botën, humbën jetën po aq të sëmurë me turbekuloz, sa edhe nga sëmundja e re infektive. Sigurisht që në emisionin e lajmeve nuk thuhet asgjë për turbekulozin, kjo sëmundje nuk përbën asnjë lloj problemi në këtë vend të pasur.

‘I gjori,’ thotë motra me një zë të përbotshëm kur reportazhi televiziv tregon djalin në një fotografi të nxjerrë një ditë vere, në bordin e një anije me vela, ku ai është me disa shokë. Ai buzëqesh ëmbël, kurse unë vë re se në dhëmbët e parë nuk ka asnjë njollë të zezë.

‘Shikoje,’ thotë ajo tek turfullon. ‘Është me të vërtetë e pakuptueshme që dikush të largohet nga jeta në një moshë kaq të re.’

‘Po,’ them unë duke liruuar kopsat e sipërme të palltos. ‘Edhe aty, ai është futur pa radhë.’

Përktheu nga norvegjishtja:: Aristidh Shqevi

BERTA

*Tregim nga
Shkëlzen Halimi*

Në studion e saj vazhdimisht shkoja në orët e mbrëmjes. Dhe sa herë që ngjitesha në katin e nëntë, më ngërthente një dëshirë që kurrë më të mos zbres poshtë. Shpesh rrugës ndalesha për të blerë lëng shege, sepse ky lëng i pëlqente shumë Bertës. Sidomos i pëlqente ta ketë gotën pranë derisa zhytej në thellësitë e pikturave, për të cilat gjithnjë thoshte se u mungon diçka.

Gjatë atij viti korridori kryesor dhe i vetëm i katit të nëntë nuk kishte dritë dhe askujt nuk i shkonte ndërmend të ankohej për shkak të djegies së poqeve të neonit. Ndonëse nuk dukej asgjë, korridorin e gjatë e kaloja me lehtësi, pasi krejt në fund, në të djathtë, ishte vetëm një derë – ajo e studios së Bertës. Sapo uleshja duke dihatur rëndë (sepse ashensorët nuk punonin), Berta i ndizte dy qirinj, i afronte gotat plastike dhe i mbushte me lëngun e shegës. Pastaj, nën dritën e qirinjve, i hidhja një shikim të gjitha pikturave, të cilat qëndronin varur nëpër mure, ndërkaq në brendinë time krijohej një ndjenjë e çuditshme, sepse më dukej se gjendesha në një botë krejt tjetër, në një botë të qetë, të rrethuar me pamje magjike, të cilat në vete kishin pjesë të dhembjes, që nuk ishte e njëjtë me atë që ende nëntë kate më poshtë. Në fakt, ne pothuaj fare nuk flitnim, por thjeshtë e shikonim herë njeri tjetrin herë pikturat, të cilat në atë gjysmë errësire më dukej se vetvetiu plotësoheshin me ngjyrat e nevojshme. Vetëm kur më thoshte Berta se po i mbyllem sytë, atëherë e kuptoja se kishte kaluar mesnata. Pa bërë zë ngrihesha në këmbë, e mbuloja Bertën me çarçafin që e ruante në një komodinë të vogël dhe dilja duke e tërhequr ngadalë derën. Derisa zbritja nëpër shkallë, hetoja se sërishmi më kthehej ajo lodhje, ai angëzshim, ajo dhembje e mërzitshme, e cila shpesh edhe bëhet monotone, pa përmbajtje, sa që të vije ta urresh edhe vetveten pa pikë të fajit.

Një natë më erdhi të ulërij në mes të shkallëve, por u përmbajtja duke u ulur për ta qetësuar dhimbjen e këmbëve. Në ato çaste ndjeva se po më rëndonte gjumi dhe u mbështeta në murin prej betoni. Kur i hapa sytë, i trishtuar nga një ëndërr e keqe, pashë se pothuaj kishte aguar mëngjesi. Sapo mora të ngrihem, ndjeva se krahu, të cilin e kisha mbështetur për murin e betonit, më ishte shtangur, më ishte bërë akull. Nuk vonoi shumë dhe më kapluan ethe drithëruese. Kur zbrita në katin përdhes, rojtari i konviktit më tha se isha bërë për spital. Më kujtohet se ai vrapoi më kapi për krahu, duke më ulur në një karrige druri. Me t'u ulur gjithçka rreth meje u mbulua nga një errësi. Dhe, kur i hapa sytë dëgjova një zë tek më tha: je në spital.

Me Bertën ndaheshim në hyrje të asaj godine të ftohtë. Ajo shpejtonte para se të mbyllet dera kryesore nga një plakush më fytyrë të vrenjtur, i cili aspak nuk ishte i mëshirshëm dhe nuk i bëhej vonë kur dikush, për ndonjë arsye objektive, nuk arrinte para mesit të natës të futej në atë godinë të ftohtë.

-Herëve tjera do të jeni më të përgjegjshëm dhe do të bëni çmos që të mos vonoheni – ishte përgjigja e plakushit.

Sa herë që shkoja në studion e saj, Berta, disi si me frikë, m'i tregonte pikturat e reja. Derisa i shikoja, ajo rrinte e shtangur dhe priste që ta jap mendimin tim. Ndërkaq unë zhytesha në brendinë e atyre pikturave, të cilat përmes



ngjyrave të zjarra ndriçonin thellësitë e shpirtit të Bertës, në pikturat e së cilës si lajtmotiv zakonisht paraqitej një portë e vogël. Dhe, pikërisht kjo portë ishte enigma e saj, për të cilën ajo kurrë nuk foli. Më së shumti më pati pëlqyer piktura, që e pati emëruar “Pritja e lindjes”, të cilën pikturë e dëmtova bukur shumë pasi në sipërfaqen e saj, përkatësisht mbi këmbën e gruas së pikturuar ranë disa pika të gjaku të gishtit tim, të cilën e gërvishta duke dashur ta vari në mur.

Ishin ditët e fundit të qershorit të vitit 1991. Berta më kishte lënë një porosi te pastruesja e ndërmarrjes ku punoja, të cilën porosi unë e mora shumë ditë më vonë. Kot ishte munduar të më telefonojë në zyrën time, sepse po asaj dite kishte pasur defekt në rrjetin telefonik. Pastaj, siç do të mësoj më vonë, Berta e kishte lutur shoqen e saj, Anën, që si e si të më gjejë, kurse ajo nuk kishte lënë skutë të qytetit pa më kërkuar, ndërkaq unë pikërisht asaj dite sërish u shtriva në spital për shkak të dhembjeve të padurueshme në krahun e djathtë.

Tre ditë më vonë, pasi dhimbjet deri diku më pushuan, ika nga spitali dhe shkova drejt e në studion e Bertës. Rrugës, u ndala para një lulishte dhe mora një buqetë me lule të freskëta, sepse doja t'i kërkoja falje për mungesën e paparalajmëruar. Në katin e nëntë (jashtë që moti kishte rënë errësira), gjëja e parë që më ra në sy ishte korridori i ndritshëm. Për herë të parë i pashë muret prej betoni.

Dera e studios së Bertës ishte gjysmë e hapur. Kur u futa brenda, ndjeva një rrëqethje. Muret ishin boshe. S'kishte asnjë pikturë pos asaj që më së shumti më pëlqente mua, “Pritja e lindjes”. Pastaj syri më kapi qiriun që e ndeza menjëherë. U ula përballë pikturës dhe shikimin e fiksova në gruan që pritet të lindë. Akoma ishin edhe pikat e gjakut tim që patën rënë mbi këmbën e saj. Ndjeva se përbrenda më zgjerohej një zbrazëti e tmerrshme. Isha në katin e nëntë, në atë shtresë të tmerrshme të Dantes, ku mungesa palosej palë – palë.

Bertë, iu pata drejtuar asaj kur më tha se e kishte përfunduar pikturën “Pritja e lindjes”, ti nuk je e tillë në shpirt, përse ke vendosur që gruan e pikturuar ta lësh në atë gjendje, me dhembje të përhershme.

Shpirti i pastër rrugën e ka të vështirë, më pati thënë Berta me lot në sy pasi e përgjaka gishtin.

Një zë foshnje më zgjoi nga gjumi që, edhe sot e kësaj dite nuk e di nëse kisha fjetur apo kisha qenë në kllapi. Dhe, kur sërish i hodha shikimin pikturës, vëreja se, megjithatë, diçka kishte ndodhur. E gjithë piktura ishte larë në gjak. Shpejt e shpejt u ngrita në këmbë dhe e afrova qiriun. Pothuaj asgjë s'kishte mbetur nga ajo që ishte pikturuar në pëlhurë. Asgjë pos buzëve të gruas.

Kur agoi dielli pashë se lulet ishin vyshkur. Më në fund u binda se Berta nuk do të kthehet më në studion e saj. Sërish, po në atë mëngjes, unë shkova në spital, ku qëndrova edhe një javë të plotë. Bertën kurrë më nuk e takova. Kurrë...

Nganjëherë mendoj se ajo e ka hapur një nga ato portat e vizatuara në pikturat e saj dhe ka kaluar në anën tjetër, te ngjyrat e zjarra që i ndriçonin thellësitë e shpirtit të saj...

PERIENDIME QË KTHEHEN PËRHERË

Tregim nga Artur Spanjoli

A të ditë binte shi pa pushim. Rrija te dritarja me perden e ngritur pak dhe me avullin a frymën që rrinte mbi xham dhe unë bëja figura me gisht. Jashtë dëgjohej zhurma e shiut. Thërmohej mbi gjethet e mëdha të rrushit, mbi tjegullat e shtëpisë. Pikat, mbasi rrokulliseshin mbi çati, mblidheshin të tëra bashkë si të burgosura dhe futeshin nëpër ulluqet e llamarinës. Pastaj me tërbim kalonin nëpër tubat e errët të shkarkimit dhe zbrazeshin me furi në çimenton rrëzë shtëpisë. Gjithkund uji lagte botën. Unë rrija duke dëgjuar këngën e shiut dhe mendoja: tani qeni me siguri, komplet i lagur te kasollja e tij, dridhet nga të ftohtët. Toka e mbushur dhe e fryrë me ujë nuk donte akoma ujë. Te baraka, nga ku vinte një erë e rëndë helmesh kimike, me siguri, Lala po mendohej të ruante veglat e bujqësisë nga uji që binte pa ndërprerje.

Kisha ardhur aty mbasi kisha ndenjur për disa ditë tek Tani. Unë, Blendi dhe Tani, me karrocë me kushineta kishim bredhur për orë, ditë të tëra, duke ngarkuar karrocën lodër për të sjellë zift në shtëpi. Më pas, me rrethin e hekurt, shtyrë nga një shufër tjetër në formë u-je, në fund e kishim bërë rrugën gati me vrap duke u kthyer te shtëpia e gjyshërve.

Lagja Ballias ishte tashmë e kredhur në heshtjen sunduese, monotone, të shiut. Nuk mund të bridhja. Do të më pëlqente të shkoja deri te rrapi i madh, të cilin e quanin Çinori, ku thoshin kishte strofullin një dhëlpër. Dhëlpër e cila ishte bërë tmerr i lagjes Ballias. Por e dija se, po të shkoja, do të ndotesha me baltën e rrugës. Mendoja shiun e rrëmbyer që lagte dheun dhe preferoja të rrija te dhoma e dajave. Aty shikoja me kujdes bllokun e dajë Lutit, të cilin ai e kishte sjellë nga ushtria. Një bllok i madh, mbushur me shkrime, fotografi të prera filmash, thënie dashurie, figura me ngjyra. Aktore shqiptare dhe figura këngëtarësh. Më dukej një luks i madh blloku i tij dhe e shfletoja me ëndje. Orë më vonë shiu pushoi. Qielli u bë i kthjellët dhe unë dola nga dhoma. Një diell i ri, i freskët, u duk sikur sapo lindi mbas asaj dite të mërzitshme plot ujë. Tek kalova korridorin, u mbusha me aromën e shiut të bahçes që kishte pushtuar sallonin. Dëgjova fishkëllimën e gjyshit që rrihte një metal me çekiç te këndi i tij i punës në aneks. Dola jashtë në verandë. Më në fund, mendova. Mund të dal të bëj një xhiro jashtë. Nuk më sheh asnjëri tani, sepse të tërë janë të topitur nga shiu. Uji kishte gjallëruar gjithçka përreth shtëpisë dhe pashë qenin e lagur i cili sapo doli nga kolibja e tij. U tund e u shkund duke hequr ujin nga leshrat e zeza. Pulat ishin kruspullosur poshtë plastmasës të kotecit dhe rrinin si të ngrira. Mora këpucët e vjetra të gjyshit, këpucë që gjyshja i quante shatra. I mbatha edhe pse ishin të mëdha dhe zbrita shkallët e çimentos në të djathtë. Zbrita poshtë. Ajri ishte i pastër dhe një aromë dheu dhe barishtesh të gjallëruara nga shiu më mbushi mushkëritë me tërfil. Zbrita poshtë, afrova turitë te zgavra e bodrumit dhe

pashë me kujdes. Me dhjetëra turi të kuq, veshë të kuq, sy qelqi inkandeshentë rrinin në heshtje duke ngrohur njëri-tjetrin. Ishin lepujt e dajës. Rrinin të gjithë aty, urtë dhe butë, duke ndarë bashkë vetminë, errësirën dhe burgun e jetës së tyre. U mundova t'i ndjell, por nuk reagonin. Pastaj vendosa të marr biçikletën 28-she të dajës. Sapo e kisha mësuar biçikletën dhe kisha lejen ta merrja. Por mbas asaj që kishte ndodhur tani ishin më të rezervuar, nga frika se mos vritesha. Dielli përflakte gjithçka me një forcë të paparë, sikur, i mërzitur nga retë e zeza, tani, pak përpara se të perëndonte, të donte të shndriste me më shumë forcë. Tek nxirrja biçikletën te rruga me guriçka, më pa daja i madh nga dritarja e dhomës së tij. “Ku shkon ti?” Unë ktheva kokën si i zënë në faj dhe u mbrojta: “Të bëj një xhiro. Ma ka dhënë lejen Lala. «Gënjeva.



Daja Sami po pinte cigare dhe përtej hekurave të dritares mezi dallohej nga shtëllungat e tymit. Nuk tha asgjë, veçse shtoi: “Kujdes se rruga ka baltë. Ruh mos të rrëshqasësh dhe vritesh!” Lëviza kokën në shenjë pohimi. Qeni filloi të hungërijë nga kasollja e vet. Dera e madhe e llamarinës, kur u hap, ia pati me një mjaullimë maceje qaramane. Sapo dola jashtë duke shtrënguar biçikletën nga timoni, u ndjeva i lirë. Aty pashë tek ecnin dy këmbë dhe mbi këto dy këmbë ecte në ajër një masë e madhe bari të thatë. Por masa ishte aq e madhe, sa njeriu brenda mund të shihte veç përtokë. Ky është Ver Hushi, mendova. Vetëm ai mund të bënte diçka të tillë.

Imagjinoja tani gungën e madhe të Ver Hushit, mbi të cilën mbështetej barra e madhe e barit që ai transportonte. U ngjita mbi mjet dhe me duart e pasigurta fillova t'i jap biçikletës së madhe. E kishte shalën prej lëkure dhe kur u jepja fort pedaleve, duhej të rrija në këmbë. Dukej tamam si një kalë i pashaluar mirë. Po mos të ngrihesha në këmbë, nuk arrija nga hekuri i trekëndëshit t'u jepja fort pedaleve. Vazhdova drejt rrugës plot baltë dhe e dija se po rrezikoja të shkisja. Kalova shtëpitë, dynimin e Lalës dhe vazhdova drejt nga rezervuari. Balta hapej me zhurmë nga kopertoni i biçikletës së madhe. Vraga të frikshme bëheshin në llucë. Po më pëlqente, por kisha edhe frikë. Nga dy anët e rrugës kishte dy kanale të mëdha plot ferra, që ndanin xhadenë me fushat e shtatorit. Po ta marrë vesh Lala, mendoja, do të nxehet me mua. Ma kishin ndaluar ta përdorja biçikletën që kur, një ditë, duke marrë kthesën në xhade, nuk ia kisha dalë dhe isha fundosur me gjithë biçikletë te kanali plot ferra. Por argëtimi ishte më i fortë se frika e paudhësisë. Tek zbrisja të tatëpjetën, se ç'ma dha truri dhe frenova kur isha me shpejtësi. Në çast e pashë veten tek fluturoja ëmbëlsisht. Akoma duke shtrënguar fort timonin e hekurt. Kur rashë, nuk ndjeva asgjë. Veç m'u kujtua Tani dhe Blendi tek ecnim me karrocë me kushineta plot me zift. Pastaj filloi dhimbja e gjurit dhe e shputave të duarve. Ishte një djegie e padurueshme. U ngrita me zor. Isha bërë tërë baltë, por me të gjitha gjymtyrët në rregull. Veçse pëllëmbët ishin të llangosura me një përzierje balte. Rrija ashtu pa kuptuar deri në fund ç'më kish ndodhur. Mbi trupin tim ishte akoma rrota e dytë e biçikletës e cila xhironte në ajër. Nuk kishte asnjëri përreth që të më ndihmonte. Dielli përtej fushës së gjerë po binte me një përsqukje të llahtarshme. Dëgjova hapa. Ishte daja Sabri tek kthehej në shtëpi pas gjithë atij kiameti. I shkurtër, me flokët e zinj me kaçurrela, me hundën e madhe tipike të Callikve, sa më pa erdhi me vrap të më ndihmonte. Më ndihmoi të ngrihesha. Tek më pyeste nëse isha vrarë, mohoja me kokë. Ishte lagur nga shiu deri në palcë. Kishte veshur pantallonat e dokut me pala, të cilat lja i hekuroste me hekurin e madh dhe të rëndë me prush brenda. Pantallona të cilat tani i rrinin ngjitur mbas trupit. “Hajde, - më tha, - ngrihu!” As nuk më qortoi, as nuk u nervozua, por më shihte me kujdes gjunjët tek ngrihesha. Unë fillova të dridhesha sa nga frika sa nga padurimi. “Ecën lirshëm?” - më pyeti ai tek më shikonte me kujdes. Unë, si i mrekulluari përpara së papriturës, fillova të hidhja me drojë hapat e parë, akoma i kërrusur si Ver Hushi. Ashtu i llangosur krejt nga fshirjet e baltës tek kisha rrëshqitur. Më dhimbte pak te vithet dhe gjuri i djathtë, por nuk ankohesha nga frika. Isha i mpirë si në ëndërr. “Mirë jam”, - i thashë. - “Nuk jam vrarë fare”. Por dridhesha nga e papritura. “Ç'm'u desh!” - foli. - “Nuk duhej të frenoja në dishezë!” Daja më futi krahun, me dorën tjetër ngriti biçikletën që i kishte dalë zinxhiri dhe tek ecnim më pyeste si ndodhi. Daja Sab ishte i treti nga dajat e mi. I shkurtër dhe me duart e fuqishme prej muratori, të gjithë e dinin sa zemër të madhe kishte. Tani, me erën e shiut mbi trup, ai lëshonte avull nga nxitimi. Ecnim duke zgjedhur rrugën në xhadenë e bërë pis dhe jo gjithçka ishte sikur bukuria të ishte

prishur e tëra në çast nga aksidenti. Biçikleta që Tani, kushëriri, nuk arrinte ta shqiptonte si duhej dhe gjithmonë e quante biçikleta. “Të lutem, mos i thuaj gjë Lalës!” - iu luta unë. - “Po futem nga deriçka e lopës. Po lahem dhe ndërrohem te baraka, pastaj heshturazi futem në shtëpi. Të lutem, dajë. Po më pa, sidomos dajë Samiu, do të mërzitet shumë dhe do të më bërtasë!” Doja bashkëpunimin e dajës.

U bëra gati të futesha nga deriçka e lopës, fshehurazi, i mbrojtur nga trupi i dajës, kur në mes të llucës së rrugës pamë të vinte me vrap një djalë i vogël. “Kanë kapur skilen (dhelprën). Kanë kapur dhelprën te çinori!” - ulërinte plot habi dhe nxitim. Kafsha ishte bërë tmerri i lagjes, sepse natë pas nate fshatarëve u mungonin pulat në kotec. Kur ngriheshin në mëngjes, shihnin me tmerr pulpat e pulave të mbytura nga kafsha, pikasin gjakun dhe rrëmujën pas kacafytjes natën.

“Kanë kapur dhelprën?!” - e pyeta i habitur.

“Po! Po!” - pohoi djaloshi. - “Po e nxjerrin me zor nga strofulli e çinorit. Pema ishte një rrap aq i madh, sa duhej një minutë t’i vije përreth veç trungut dhe nga të çarat e të cilit shpesh nxirrnin kokën ketrushë e qukapikë. Aty thoshin strehohej dhelpra gjatë ditës dhe vetëm natën, dinake siç ishte, dilte për të kapur pulat e lagjes.

Pashë dajën Sabri sikur të doja t’ia blija mendjen dhe ai pohoi me kokë. “Shko!” - më tha. Duke u pllakuritur nëpër llucën e lagjes *Ballias*, shkuam deri te çinori. Pema ishte aq madhështore, sa jo vetëm nuk dihej kur dhe kush e kishte mbjellë, por nëpër degët e saj mund të strehoheshin të gjithë zogjtë e qiellit. Ishin tre djem të cilët, me shkopinj të gjatë të futur thellë në një zgavër të trungut, mundoheshin të nxirrnin jashtë dhelprën. “Aty është. Aty!” - ia bënin kalamajtë përreth, të cilët betoheshin që e kishin parë tek fshihej nën shi. Ajri ishte akoma i lagësht dhe dielli me forcën e tij të llahtarshme depërtonte gjethnajën e pafund të rrapit. Përreth, fushat në perëndim i kishte mbytur e kuqja e diellit. “Nuk rri dhelpra aty, more të keqen xhaja”, - ia bënte një plak i kërrusur si kosë qeshte, i argëtuar nga kurioziteti i djemve. Më në fund, tre djemtë hoqën dorë nga qëllimi i tyre. Në momentin që po iknin dhelpra nxori turirin nga e çara, por në të njëjtin moment një gur i rëndë goditi fort trungun. Dhelpra e tmerruar, me një lëvizje të zhdërvjellët prej maceje elastike, kërceu jashtë. Atëherë djemtë iu turrën mbrapa me shkopinjtë e ngritur. “Dhelpra! Dhelpra!” - dhe mundoheshin ta qëllonin. Fëmijët i ndiqnin nga prapa, por, ngaqë rruga ishte tërë baltë prej shiut, ecja bëhej më e vështirë dhe njëri nga djemtë rrëshqiti. “Dhelpër e mallkuar që na han pulat!” - u dëgjua të thoshte dikush. Plaku po shkrihej gazit. Ishte aq i vjetër dhe me aq shumë rrudha, sa as nuk e mbante mend tashmë kur kishte lindur. Rrinte pak i kërrusur, me sytë që i nxirrnin xixa, qelshen në kokë, xhaketen e zbardhur nga koha dhe shkopin mbërthyer në dorë. “Po lëreni more të shkretën të ikë!”

“Si të ikë, o xhajë? Ajo po na i han tërë pulat e lagjes!”

“Po pulat kushedi se kush i vjedh natën në lagje. Lëreni kafshën rehat!”

Rrija sa i shtangur, aq kurioz dhe i mrekulluar. Nuk kisha parë kurrë një dhelpër për së gjalli. E kishte turirin e gjatë, bishtin e madh kaf dhe sytë me të vërtetë shumë dinakë. Një dhelpër e cila tani po ia mbathte tërë frikë, ndërkohë që nga të gjitha anët copa guri dhe tullash të thyera mundoheshin ta godisnin. Kam harruar shumë gjëra, por dhelprën që rendte poshtë tokës së përbaltur nuk arrij ta harroj. Dhe pak më tej perëndimi i entuziazmua, përflakte lumin Erzen, fushat e gjelbëruara dhe xhamat e serrave të përndezura nga copat e kuqe të diellit në rrënjë. Pas shiut ajri ishte i qëruar si qepujkë dhe dielli ndrinte më fort. Perëndim i cili kthen përherë.

LOJË

Tregim nga Besa kalaja



A të natë vdiqa pas një qetësie që më kishte kapur prej ditësh. Shmangesha nga gjithçka, pija më pak dhe haja më pak natyrisht. Rehatinë më prishnin vetëm shtëpitë, oxhaqet e të cilave nxirrnin tym pa ndërprerë. Mjegullnaja që krijohej më përzihej me një lloj papastërtie të llahtarshme të ajrit sa që dukej që do të mi nxirrte zorrët. Vetëm e imja nuk po nxirrte tym dhe duket që kjo ishte shenjë që herë pas here vinin fqinjët për të parë mos kisha vdekur.

-Edhe vdekja e ka njëfarë rendi- u thosha duke u ngërdheshur.

Dhe ata bënin sikur po habiteshin që po e dëgjonin këtë.

-Vërtetë?- ma bëri një zonjë, edukata e saj nuk e linte të më thoshte, mos na shurdho me budallallëqe.

-Vërtetë, i thashë unë, ashtu është, dhe këtë e bëra vetëm për faktin se kisha dëshirë të madhe t’ia acaroja nervat.

-Mirë. më tha ajo, po tani e tutje kur ne vijmë për t’ju pyetur në keni vdekur, të paktën na thuaj se edhe pse vdekja ka njëfarë rendi, ajo di edhe të befasojë.

Gati më shkoi mendja ta pyes a vërtetë ishte kaq budallaqe apo kishte kuptuar lojën time sa tani po ma luante ajo mua këtë lojë.

Seç e kanë gratë një aftësi për të të mundur atëherë kur ti veç e ke krijuar përshtypjen që je i fituar. Kështu më ka ndodhur rëndom. Ish e dashura ime që bënte gjithçka për mua, më lante rrobat, përgatiste ushqimet, më shikonte natën në kam fjetur apo mos jam zbuluar, më blinte rrobat, cigaret, uiskin, gazetën, librat, kujdesej që mbi tavolinën ku unë mbaja këmbët, ta pastronte, të mi lëkundte këmbët me kujdes që aty t’mos mbetej pluhur, më sillte kafën e mëngjesit, atë të drekës, mi dërgonte letrat në postë, paguante faturat...dhe në kohën kur ti kishe krijuar komoditetin e të djallëzuarit, sepse në të gjitha rastet nuk është se të vinte keq apo ndonjëherë t’i thoshe nuk janë gjithë këto punë për ty, jam edhe unë këtu, vetëm kur ia pashë fytyrën e vrenjtur.

-Çfarë ka ndodhur?

-Asgjë.

-Më duket nuk je mirë?

-Jam, por nuk dua të jetoj më këtu.

-Çfarë unë mendoja sikur...

-Sikur çka?

-Nuk e di.

Vajza erdhi herët në mëngjes.

-Nëna më dërgoi të shoh a jeni ende gjallë?- më tha.

- Cila nënë?, i thashë unë Se kisha parë kurrë, se dija fëmija i kujt ishte.

-Ja kjo shtëpia e lyer me ngjyrë portokalli, shikoni kjo, bëri dy hapa drejt meje dhe mu ngjesh në trup.

-Je vajza e asaj gruas thananike, i thashë duke mos qenë i sigurt a e kuptonte fjalën thananike.

-Nëna ime është mësuese më tha dhe nga fytyra e pashe që fjala thananike e bezdisi shumë.

Edhe atë natë vdiqa pas një qetësie që më kishte kapur prej ditësh...

-S’ke vdekur ende?

-Jo.

-Kur e ke ndërmend ta bësh?

-Bëra mbrëmë një provë.

-Si kështu provë?

-Ja pra një ceremoni mortore organizova. Vendosa qirinj rreth e qark dhomës, lëshova Beethovenin, fika dritat, u shtriva në çarçafët e bardhë, mbylla sytë dhe engjëjt mu shfaqën vetëm pas pak.

-A po?

-Po.

-Dhe lëshove muzikë klasike?

-Po, a nuk bëhet kështu sa herë vdes dikush? Muzika klasike duket se i shkon shumë vdekjes.

-A i marrë je ti, mos po mendon që je aq i rëndësishëm sa dikush në ceremoninë e vdekjes tënde të lëshojë muzikë klasike. Pse kush je ti,- mos më je ndonjë burrështeti a ku di unë, artist a ku di unë sepse po më merret goja nga budallallëqet që mi thua këtu. Dhe mos vdis në këto kohë me këtë mjegull kaq të madhe. Kam frikë se kur të dërgojmë te varrezat, mund të ketë vdekur edhe dikush tjetër dhe mund t’i ngatërrojmë kufomat. Nuk do të mund ta përballoja që në varrin tënd të prehej dikush tjetër. Nuk do të doja që mallkimet afër varrit tënd që do ti bëja të shkonin në adresë të dikujt tjetër. Prandaj mos vdis në mjegull, mos vdis në këtë pisllek.

-Dëgjomë! Përveç se të të pyes a ke vdekur, kam ardhur të të fus një grusht fytyrës. -Pse gratë tona shqetësohen kaq shumë se a do të vdesësh ti apo jo? Çfarë ju hynë në punë atyre- vdekja jote është veç e jotja. A është kështu? Pse gruaja ime duhet të përgatis lloj-lloj ushqimesh për ty. Mbrëmë deri vonë ka përgatitur mish, turshi të llojllojshme, reçelna, lëng me fleta trëndafili, çaj me thana, të cilat i kishte vjelë vjeshtës së kaluar, tortë me çokolllatë me një përqindje të madhe të kakaos, kafe, t’i kishte larë e hekurosur këmishat, çarçafët... kur po e kujtoj më vjen të çmendem.


Qafa ju skuq, i dilyn jargë nga goja dhe bënte me duar drejt meje po pa guxuar të më bjer.

-Dhe je i shëmtuar, prandaj nuk e di çfarë do ajo prej teje. I gjatë, i hollë, me mustaqe, me ato syza që nuk të rrinë mirë në kokën tënde të vogël. Plus je depresiv, pa jetë.

-Çfarë, unë me gruan tënde, me gratë tuaja madje sepse ti po më flet në shumë. Jo, asnjëherë. Në veçanti gruaja jote nuk më pëlqen aspak, e gjatë, e shëndoshë, fytyrën pa formë. Mua më pëlqejnë gratë elegante, se ke kuptuar këtë- po pra, eleeeeganteee dhe po i bërtisja po kjo brenda meje s’më krijonte asnjë shqetësim. Po aktroja në fakt. Nuk e parashikova që fakti që po ia shaja gruan do ta acaronte edhe më shumë. Më vuri gishtin në hundë, u skuq dhe po mundohet të thoshte diçka. S’po e kuptoja. Me shtypi hundën me forcë dhe ma ktheu shpinën me vrap.

-Jo nuk mendova ashtu, u nguta ti them, ishte vetëm një përpjekje për të të qetësuar. U zhdruk në mjegull.

Atë natë vdiqa vërtetë.



TIM PARKS

PËRKTHYESI I
PADUKSHËM*The New York Times*

Përktheu Granit Zela

Sa i rëndësishëm duhet të jetë për ne identiteti i një përkthyesi? Studiuesit e studimeve të përkthimit u kanë kërkuar përkthyesve për vite me radhë që të jenë më të dukshëm. Libri me ndikim i Lawrence Venuti-t, *Padukshmëria e përkthyesit* (1995), argumentoi se praktika e shpërfilljes së identitetit të përkthyesit, deri në atë pikë sa ta mohonte veprën si përkthim, ishte pjesë e një mendësie të padobishme hierarkie që i jep vlerë absolute origjinalit, dhe shpërfill faktin se çdo përkthim i ri është në vetvete një vepër e re artistike. Venuti e shihte vokacionin e përkthyesit edhe si politik edhe si përparimtar, pasi punonte në një mënyrë të tillë që ta kalonte “gjuhën e synuar... përtej “një vijeje arratisjeje” nga hierarkitë kulturore dhe shoqërore që mbështet ajo gjuhë, duke ia hequr përkthimit “përkatesinë gjeografike”. Kjo mund të bëhet në aleancë me tekstin origjinal, ose duke i rezistuar tij. Teza nënkupton një marrëveshje të gjerë se është mirë të arratisesh nga hierarkitë kulturore dhe shoqërore dhe t’ia heqësh “përkatesinë gjeografike” gjuhës, edhe nëse hierarkia shoqërore dhe gjuha e përkthyesve mund të jenë krejt e ndryshme nga e atyre që shkruan librin që po përkthejnë.

Nocioni i përkthimit “rezistues” u mbështet nga disa studiues që propozuan lexime feministe të veprave letrare. Emily Wilson e përshkroi përkthimin e saj të *Odisea* në vitin 2017, përkthimi i parë në anglisht i kësaj poeme nga një grua, si përkthim që “hedh një dritë të qartë në forma të veçanta të seksizmit dhe patriarkatit që ekzistojnë në tekst”. Në një rast të tillë, ku më tepër sesa paraqitja e një kritike të tekstit letrar me një hyrje ose shënime në fund të faqes, përkthyesi kërkon me vetëdije të vërë në pah aspekte të tilla jo tërheqëse, mund të jetë më me dobi që lexuesi ta dijë se kush është dhe nga është përkthyesi.

Në një recensë që shqyrtonte tre përkthime të Orestias së Eskilit, vetë Wilson tregoi se sa e rëndësishme ishte për të, të dinte identitetin e një përkthyesi, duke vërejtur se ajo ishte zhytur në trishtim kur kishte kutpuar se dy prej përkthimeve ishin bërë nga burra të bardhë, të moshuar, të dy profesorë emeritus, dhe tjetri nga një i bardhë më i ri, që s’ishte akademik. Wilson pranon se është “mjaft e lehtë për këdo, me çfarëdo prejardhje shoqërore ose identiteti, të përsërisë të njëjtin vizion të vjetër të lodhur të të njëjtave tekste të vjetra”, dhe është “shumë e mundur, në teori, që burrat e moshuar të bardhë të ofrojnë ide origjinale dhe perspektiva të reja”. Sidoqoftë, duke parë përkthimet në fjalë, “ngjashmëritë midis tyre, veçanërisht në materialin paratekstor, sugjerojnë një lidhje të pjesshme të ndërsjelltë

midis pozitive shoqërore të përkthyesve dhe leximeve që ata i bëjnë Orestias”.

Me pak fjalë, siç e sheh Wilson, prejardhja shoqërore ndikon në përkthimin që ti bën. Dhe kjo të çon në këto përfundime: së pari, është e dobishme të njohësh identitetin e përkthyesit; dhe së dyti, do të ishte më e dobishme që në ripërkthimin e veprave klasike do të kishim më shumë përkthyes që janë gra dhe që s’janë të bardhë. Wilson jep statistika që tregojnë mbizotërimin e meshkujve të bardhë në fushën e përkthimeve klasike; kur bëhet fjalë për botën e përkthimit në përgjithësi, mbizotërimi është pa dyshim i të bardhëve, por vështirë se është i përkthyesve meshkuj.

Po të lëmë mënjatë çdo vlerësim me ngarkesë politike, duhet thënë se gjatë viteve të fundit është vënë re tani po botohet më shumë letërsi e huaj dhe përkthyesit po bëhen më shumë të dukshëm. Çmimi Ndërkombëtar Booker për veprën më të mirë letrare të përkthyer tani jep shuma të barabarta parash (rreth 25.000, ose 35.000 dollarë) si autorit edhe përkthyesit. Çmimet posaçërisht për përkthyesit janë shumëfishuar. Tani ka çmime për përkthyesit e rinj dhe çmime për gratë përkthyes. Edhe në rastin e pazakontë i Elena Ferrante-s, pseudonim për një autor anonim italian, romanet jashtëzakonisht të suksesshme të saj në promovime janë “paraqitur”, mund të themi, nga përkthyesja në gjuhën angleze Ann Goldstein, dhe kjo ka çuar në shtimin e vetëdijesimit të publikut për personalitetin e përkthyesit. Po kështu, polemikat që lidhen me përkthimin nga Deborah Smith të romanit të vlerësuar me çmime letrare *Vegjetaria* të Han Kang e ka bërë më të nxehtë debatin mbi llojet e lirive që mund t’i japë vetes përkthyesi gjatë përkthimit. (Është interesante që Goldstein dhe Smith kanë qasje krejt të kundërta ndaj zanatit të tyre - Goldstein zgjedh respektin e rreptë të tekstit dhe sintaksës së origjinalit, Smith pohon me guxim se “besnikëria” është koncept i tejkaluar, çorientues dhe i padobishëm kur bëhet fjalë për përkthimin”.). Në çdo rast, asnjë festival letrar s’është i plotë nëse s’ka diskutime për përkthimin, diskutime të cilat zakonisht janë mjaft të ndjekura.

Ndodhi që në këtë skenë emocionuese, shumë herë të trazuar, erdhi lajmi se dy përkthyes evropianë të ngarkuar të përkthenin veprën e poetes së re zezake amerikane Amanda Gorman (e cila u bë e famshme pasi lexoi në ceremoninë e inaugurimit të Presidentit Biden) më pas kishin hequr dorë ose ishte tërhequr për shkak të çështjes e identitetit. Megjithëse janë të bardhë, të dy përkthyesit vështirë se mund të ishin më të ndryshëm. Shkrimtarja holandeze që gjakon të jetë përkthyes Marieke Lucas Rijneveld, njëzet e nëntë vjeçe, fitoi

vjet Çmimin Ndërkombëtar të Booker për romanin e parë, *Trazimi i mbrëmjes*, i cili, siç shprehet vlerësuesi i Neë York Times, “është plot me...të gjitha ndyrësitë e jetës”. Identifikimi i personazheve në roman me përemra që s’tregojnë gjini duke mohuar gjininë mashkullore dhe femërore, e bëri Rijneveld-in një personalitet shumë të dukshëm për t’u rreshtuar me poezitë e Gorman-it, dhe për ta përkthyer megjithëse për aq sa kam kërkuar, nuk kam mundur të ndonjë përkthim të botuar me emrin e tyre. Zgjedhjen të tërhiqeshin nga projekti pas kritikave nga gazetarja Janice Deul, e cila shkroi se ishte humbur një mundësi për të zgjedhur “një artist të fjalës së folur, të re, femër dhe zezake pa pasur nevojë të shfaqësohet për këtë”.

Përkthyesi tjetër në këtë rast, Victor Obiols, është një poet i njohur katalanas, gjashtëdhjetë vjeç, përkthimet e tij të respektuara përfshijnë vepra të Shekspir, Oskar Uajldit dhe të Walter de la Mare, ashtu si edhe shumë libra për xhazin, rokun, romane grafike, romane për fëmijë, dhe shumë më tepër. Lu hoq përkthimi i Gormanit sepse, sipas fjalëve të tij, botuesit, ose ndoshta agjenti i autorit, “po kërkonin një profil tjetër, duhej të ishte grua, e re, aktiviste dhe mundësisht zezake”. Dhe shtoi: Nëse s’mund të përkthej një poetë sepse ajo është grua, e re, zezake, një amerikane e shekullit njëzet e një, atëherë s’mund të përkthej as Homerin sepse s’jam grek i shekullit të tetë para Krishtit. Po kështu s’do të mundesha të përktheja Shekspirin sepse s’jam anglez i shekullit të gjashtëmbëdhjetë. S’është e lehtë ta diskutosh këtë çështje të mprehtë pa u bërë pjesë e një debati tejet të polarizuar. Është e qartë, përkthimi ka një prirje të brendshme për të kapërcyer pengesat - siç e ka thënë Paul Auster-i: “Përkthyesit janë... instrumentet kaq shpesh të harruar të cilat bëjnë të mundur që kultura të ndryshme të flasin me njëra-tjetrën, ato që na kanë mundësuar të kuptojmë se ne të gjithë, nga çdo pjesë e botës, jetojmë në një botë”. Pengesat e çdo lloji hasin në vështirësi nga më të ndryshmet por kapërcehen vetëm prej një gjakimi të tillë. Dhe megjithatë...

Më lejoni të mbështetem në përvojën time për të propozuar një mënyrë të menduari për këtë çështje. Meqenëse në Itali mbërrita kur isha njëzet e pesë vjeç, fillova të përkthej disa vjet më vonë, kryesisht materiale që lidheshin me biznesin dhe teknike të çdo lloji. Shpesh, ndieja se isha personi i gabuar për këtë punë: hiqja të zitë e ullirit me terminologjinë e stomatologjisë dhe gurorëve, sintaksën e stërholluar të kritikëve italianë të artit, prozën e zbukuruar të broshurave turistike, protokollet e kontratave ligjore. Angazhimi me përkthimin letrar ishte çështje identiteti. Një tjetër përkthyes italo-anglez, Isabel Quigley, nuk u ndje

mirë gjatë përkthimit të disa faqeve të *La cosa* të Alberto Moravias të cilat sipas gjykimit të saj ishin të turpshme. Duke mos dashur të identifikohet me këtë përmbytje, ajo hoqi dorë. Botuesit kishin nevojë të gjenin një përkthyes sa më shpejt të ishte e mundur, unë isha i gatshëm dhe s’kisha vërejtje për skenat seksuale të romanit.

Megjithatë, më vonë, s’do të pranoja të përktheja libra që në anglisht e ndjeja se kërkonin stile të të shkruarit të cilat thjesht nuk ishin “të miat” dhe s’mund t’i përktheja. Ka qenë një roman nga autori homoseksual Aldo Busi, *Jeta standarde e një shitësi të përkohshëm të getave*, i cili përdorete gjuhën italiane të theksuar baroke të tregtisë së veshmbathjeve, të cilën s’mund ta imagjinoja ta riprodhoja në anglisht. Dhe ishte një roman i mrekullueshëm nga Enrico Brizzi, *Jack Frusciante braktisi bandën muzikore*, që kërkonte të jepja në qindra faqe zhargonin urban të adoleshentëve, ndërkohë që unë kishte shumë kohë që jetoja larg Britanisë. Në secilin rast, nuk e mora përsipër përkthimin jo prej çështjes së identitetit, por për shkak të stilit. E shijova leximin në Italisht të Busi-t dhe Brizzi-t dhe m’i përcollën botët e tyre shumë fuqishëm. Kjo është ajo që bën letërsia. Thjesht ndjeja që nuk kisha instrumentet e duhura në anglisht për t’i përkthyer.

Nga ana tjetër, e përktheva *Është një vend në botë: një grua në Birkenau* të Giuliana Tedeschi-t. Ky libër kujtimesh tronditëse për një vit të kaluar në një kamp përqendrimi nazist përqendrohej shumë në trupin e femrës, humbjen e ciklit menstrual, frikën se femra s’mund të bëj kurrë fëmijë dhe shumë gjëra të tjera që ishin të dhimbshme vetëm po t’i mendoje. Kam përkthyer edhe *Ditët e ëmbla të disiplinës* të Fleur Jaeggy-t, rrëfim në vetën e parë i një dashurie lezbike të penguar në një shkollë me konvikt vajzash. Në asnjë çast s’kisha merakun se s’mund të jepja versione besnike të historive të këtyre grave pavarësisht se ishin larg përvojës time jetësore, sepse ato ishin shkruar brenda një tradite letrare që e njihja. Ishte çështja e gjetjes së të njëjtit ton zëri, të njëjtave kadenca, të njëjtës gamë leksikore në anglisht, pas së cilës fjalëve, mendova, mund t’u besojë të bënin pjesën tjetër. Faqet e përkthimeve si provë që ua dërgova redaktorëve, meshkuj dhe femra, u miratuan menjëherë dhe recensat përfundimtare të punës së përfunduar ishin të favorshme. Romani i Jaeggy-t në veçanti do të arrinte njëfarë fame.

Sidoqoftë, dy ngjarje sugjeruan që edhe asokohe, në vitet 1990, çështjet e identitetit po bëheshin të rëndësishme për përkthimin. Kur i dërgova shtëpisë botuese Women’s Press në Angli disa faqe të përkthyerat të *Le confessioni di una piccola italiana*, rrëfim anonim i përvojës së një vajze të re në regjimin fashist duke sugjeruar se ata mund të dëshironin ta botonin librin, më thanë se u kishte pëlqyer shumë ajo që kishin lexuar, por unë, ngaqë isha burrë, nuk isha përkthyesi i përshtatshëm. Krejt ndryshe, shkrimtarja Oriana Fallaci i kërkoi posaçërisht botuesit që të më ftojë të përkthej romanin e saj *Inshallah*. Ajo kërkonte me ngut, siç më thanë, një “autor shumë burrë” si përkthyesin e saj. Si e kishte krijuar atë përshtypje për mua? Çfarë ndryshimi bënte në përkthimin e librit fakti që isha burrë? Siç ndodhi, unë tashmë e kisha provuar ta lexoja *Inshallah* dhe kisha hequr dorë, pasi stili m’u duk plot emfazë. Nuk ishim krijuar për njëri-tjetrin.

Një ndodhi tjetër para se të nxjerrim disa përfundime. Për njëzet e ca vjet, jam mësimdhënësi i përkthimit në nivel pasuniversitar në Milano. Kohë pas kohe, u kërkoja studentëve të mi italianë të përkthenin, midis pjesëve të shumë librave të tjerë, faqet e para të *Rrëfimet e një të varuri nga bukuria*, roman magjepsës, mund të them pa ndrojtje “letërsi e grave të reja” me autore Nadine Haobsh. Fillon me rrëfimin gazmor për gjëmën e ngjyrosjes së flokëve. Ka kaq shumë detaje teknike. Klasa ime gjithmonë përbëhej nga të paktën 90 përqind gra. Megjithatë më kujtohet rasti kur një djalë i qetë krijoi versionin përkthimor që e bëri të gjithë grupin të shkulej së qeshuri dhe të bërtiste: “E saktë” dhe “E përsosur!” “Si e bëtë? –pyeti një e re. -E kam në kokë - tha ai - kam dëgjuar motrën të flasë kështu në banjë.

Atëherë, ku na lë kjo përballë përkthyesve evropianë të një gruaje të re zezake poete? Kur dëgjon përsëri performancën e Amanda Gorman-it në inaugurimin e Biden-it, shtangesh nga përhapja e gjerë publike e veprës së saj. Fjalët që përdor, të paktën në këtë poezi, janë populllore, retorika është e njohur brenda një tradite amerikane. Titulli, “Në kodrën ku ngjitemi”, kuptohet menjëherë se është analogji. Ajo do që ta kuptojnë të gjithë. Në të njëjtën kohë, ritmet e forta të poezisë, si valë që ngrihen dhe ulen, me rima të shpeshta të brendshme, përsëritje dhe lojërat me asonancë janë të forta, të efektshme, dhe të pagabueshme.

Do të ishte eksperiment interesant të krijohet një grup, për shembull, me përkthyes italianë, të gjithë me përvojë në të shkruarit ose në përkthimin e poezive, por të jenë të moshave, etnive dhe gjinive të ndryshme, dhe të ftohen të paraqesin versione përkthimesh që botuesi më pas mund t’i shqyrtojë pa njohur autorët. Nuk dyshoj do të jetë e vështirë të merret me mend se kush është autori i çdo përkthimi. Suksesi i secilit version do të varet nga përvoja -përvoja e jetës, me lëvrimin e gjuhën dhe letërsisë –në mënyrë që secili përkthyes mund ta sjellë në veprën e përkthyer. Dhe, sigurisht, versioni i përkthyer do të varet nga shkathtësia dhe aftësia krijuese në italisht. Në këtë mënyrë mund të arrihet në një version të fuqishëm.

Por s’jam i sigurt se këtë duan botuesit ose agjentët letrar, apo se kjo është ajo për të cilën shqetësohen. Përkthyesit kanë kërkuar të jenë shumë më të dukshëm dhe tani duhet të jetojnë me atë që kanë dashur. Por për sa më përket mua, nuk besoj se ky lloj përafrimi i identitetit shkrimtar-përkthyes, me të gjitha kufizimet që do të vendoste, është mënyrë e dobishme as për të çuar përpara një kauzë dhe as për të na dhënë përkthimet më të mira. Më e pakta, do të tjetërsonte shumë natyrën e punës. Kur unë përkthej veprën e një shkrimtari tjetër, nuk kam dëshirë të bëhem zëdhënës i autorit, ose të jem pjesë e rrëfimit; thjesht bëj gjithçka që mundem për ta rikrijuar me sukses në gjuhën angleze atë që ka shkruar. Dhe kur përkthehen romanet e mia, zakonisht nga gratë, asnjëherë s’më shkon në mendje të pyes për prejardhjen e përkthyesve apo të vras mendjen se mund të ketë diçka mashkullore të papërkthyeshme në shkrimet e mia që ato s’mund ta japin. Janë profesionistë dhe kam besim se do të bëjnë punën e tyre. Kjo është marrëdhënia shkrimtar-përkthyes që garanton mënyrën më të mirë për të gjithë për të ecur përpara.

LAVDËRIMI I PËRMORTSHËM PËR NJË LIDHËSË KËPUCËSH

Tregim nga I. B. SINGER

Përktheu Fatmir Alimani

Unë isha ulur në një bankë, në një park, kur vura re që lidhësja e majtë ishte zgjidhur. Kur u përkula për ta lidhur përsëri, ajo u këput. Një pjesë mbeti në këpucën time dhe tjetra në dorën time.

Si ndodhi kjo?

Sot në mëngjes, kur unë i lidha dy lidhëset e mia, ato kishin një dukje të fortë dhe një gjendje të përsosur, që të dyja. Ose, unë nuk kisha parë, që kishte një ndryshim ndërmjet të majtës dhe të djathtës? A mos e kisha tërhequr tepër fort të majtën, tashmë të vjetëruar, pa parë si ishte puna? Dhe përveç kësaj, përse pikërisht kjo? A ishte ajo më shumë e ekspozuar ndaj presioneve, fërkimeve të forta, dhe lagështirës? A ishte shkaktuar kjo nga shkujdesja ime? Unë nuk do ta di këtë, kurrë. Ne nuk i kushtojmë kujdes çdo ditë, lidhësave të këpucëve, ne nuk e studiojmë historinë e tyre, ne nuk e mbikqyrim higjienën e tyre. Por edhe sikur ta bënim, ne nuk do të ishim, me sa duket, të aftë për të parashikuar momentin e saktë, kur ato do të ishin jashtë shërbimit.

Unë nuk kam si bëj ndryshe, përveçse të heq copën e mbetur. Si e bëra këtë gjë, unë shqiptova lavdërimin e saj:

“Lidhëse, thashë unë, ti e ke mbajtur besnikërisht këpucën time, të lidhur mirë. Ti ke punuar gjer në kufi të forcave të tua, për të kryer punën, për të cilën, ti ishe bërë. Tani, ti nuk je më një lidhëse, ti je pjesë e tokës, e kozmosit. Molekulat e tua do të ndahen ngadalë dhe do të bashkohen me të tjera. Ekziston madje një mundësi, që ato të shpërbëhen në seri të ndryshme atomesh. Ti mund të jesh një ditë pjesë e një bime , e një krijese, e një minerali. Periudha jote si lidhëse këpucësh ka mbaruar, por diku në historinë e universit, atje ku është shënuar gjithçka, do të shënohet, ajo që ti ke bërë. Në regjistrin e madh të zotit do të shkruhet, që ti ishe një lidhëse këpucësh në aksh epokë, që ti ke lidhur aksh këpucë, dhe pastaj, një ditë, roli yt mbaroi, siç mbarojnë gjithë gjërat, herët ose vonë.

Nuk ekzistojnë lidhëse këpucësh të përjetshme. Vetëm elementet prej të cilëve janë bërë, ekzistojnë. Dhe nëse kjo nuk është fakt, ato janë pjesë, me sa duket, e një substance ose e një lënde që, ajo, është.

Në realitet, ti nuk ke pushuar kurrë të jesh univers. Gjatë kohës që ti e mbaje këpucën time, të lidhur mirë, ti ishe energji, lëndë, intelekt. Ti rrotullohesh, në të njëjtën kohë që toka rrotullohet rreth aksit të saj. Ti rrotullohesh rreth diellit. Ti lëviz me të, në një drejtim të panjohur, diku në Kashtën e Kumtrit, dhe kështu, ti bën pjesë në lëvizjen e galaktikave të tjera.

Të gjitha ligjet e universit janë të tuat.

Gjithë misionet e tij janë misionet e tua.

Ti ishe njëkohësisht një lidhëse këpucësh dhe kozmosi, duke luajtur për një kohë rolin e një lidhëseje. Nuk është e nevojshme të qajmë për ty. Ti nuk ke nevojë për lavdërimin tim të përmortshëm. Kjo që unë jam duke recituar, nuk është bërë për ty, por për mua, një fragment i universit, i paracaktuar që të jetë egoist, frikacak dhe injorant, për një numër vitesh dhe për një arsye, që vetëm zoti e di.”



Lisa Zeidner na kërkon të mendojmë thellësisht rreth kënd-
vështrimit në letërsi

ALEANCA LETRARE MË E MADHE E TË GJITHA KOHËRAVE: JU, AUTORI DHE PERSONAZHI

Nga LISA ZEIDNER

E përktheu Engjëllushe Shqarri

Ka gjithnjë një marrëdhënie treshe në leximin e një libri: ju, autori dhe personazhi.

Të paktën një treshe, megjithëse, në romanet e gjata, trashja mund të vijë e të bëhet një familje e stërmadhe, fisnore, poligame.

Mund të jeni në Paris, ose në Pitsburg, në shtrat ose në një kafene, me një libër (ose pajisjen e leximit) në dorë, duke lëvizur ose jo buzët gjatë leximit, teksa sytë tuaj zhbirojnë faqen. Edhe nëse jeni anëtar i një klubi leximi, përsëri leximin e bëni vetëm. Edhe autori, në mos qoftë James Patterson-i me punishten si të Santës, ku xhuxhët e tij i nxjerrin thrillerat si simite për ndjekësit e tij të panginjur, vetëm është është në krijimin e personazheve që, kryesisht, nuk ekzistojnë përveç se kur ai i krijon ata si Frankeishtajnë, duke i hedhur në jetën plot andralla. Edhe kur personazhi zëvendëson autorin, i fshehur pas një velloje të hollë—një njeri nervoz por i dashur, me një jetë dashurore dështake, ose një veteran që përpiket t'i përshtatet jetës prej civili pas luftës që i mori këmbët – tekefundit, ai është vetvetiu një pikë lidhjeje mes jush.

Gjithsesi, të pajtohem me faktin që detyra e krijuesit letrar është të na bëjë të ndiejmë diçka në lidhje me mikun e tij imagjinar, ose me binjakun e lig, që i pëshpërit në vesh për të bërë gjëra të këqija. Mund të ndiejmë simpati për personazhin, të merakosemi për të, të pikëllohem për humbjen e tij, të shpresojmë ethshëm për suksesin e tij, apo madje edhe të ndiejmë një farë magjepsje të sëmurë për të, ndonëse mund të rastisë që të jetë vrasës serial.

Nëse jeni një tip nga ata që pëlqejnë diagramin Venn¹ mendoni për tre flluska të bukura të rrumbullakëta, ku secila endet e vetme dhe e sigurt në botën e vet të mbyllur, të quajtur “Lexuesi”, “Autori,” “Personazhi”—dhe pastaj shihni se sa shumë këto flluska mbivendosen. Dhe pikërisht në dhembshurinë apo përkitjen midis këtyre subjekteve – metaforën apo ngjyrën e bojës zgjidheni vetë—qëndron edhe empatia.

Ndonjëherë, autori dhe lexuesi krijojnë grupin e tyre si vëllezër, duke e soditur me ftohtësi personazhin nga larg, duke u gjasur apo mbetur gojëhapur me të, duke gjykuar budallallëqet e tij, duke e vështruar tek i merren këmbët. Ndonjëherë, autori u flet për botën kaq shumë nga perspektiva e personazhit, sa që në një farë mënyre harroni fare që autori është i pranishëm. Ju duket sikur jeni vetëm me personazhin në një sallë ngrënieje të zbrazët të larë nga drita, pasi ka kaluar ora e mbylljes, si të ishit në një pikturë të Hopper-it. Sigurisht, jeni i vetëdijshëm se në të vërtetë nuk është kështu, sepse me gjithë shtysën për ta “flakur tej mosbesimin”, e dini se shkrimtari është ai që e ka krijuar historinë. Por, ndërkohë, njehsimi me personazhin është kaq i plotë sa që të treve – autor, personazh dhe lexues – ju duket

1 Diagram me dy rrathë që mbivendosen, përdoret për të përshkruar ngjashmëritë dhe ndryshimet midis dy koncepteve.

sikur po notoni në sinkron, diçka që e keni bërë zakon, ose sikur keni hyrë këmbadoras drejt e në kokën e heroit përmes portalit të vogël të çuditshëm në katin 7 tek filmi **Being John Malkovich** (Të jesh John Malkovich-i).

Të supozojmë se subjekti bën fjalë për një divorc problematik. Autori mund të zgjedhë të mbajë një anë – të themi, atë të gruas së shkretë, të tradhtuar, të mbytur nga problemet (Filmi **Heartburn** (Dhimlja e zemrës) i Nora Ephron-it). Nëse personazhet kryesore janë dy bashkëshortët konfliktualë, autori mund të shërbejë si një lloj ndërmjetësuesi, duke u dhënë kohë të barabartë versioneve të historive të dy bashkëshortëve dhe duke ju ftuar që si lexues të jeni i paanshëm, ose të jeni dëshmitar i masakrës martesore, duke shprehur mosbesimin për atë që po ndodh. Autori mund të zgjedhë një arbitër të besueshëm për të siguruar drejtësi, rol i marrë përsipër nga avokati i divorceve tek libri i Warren Adler-it **The War of the Roses** (Lufta e trëndafilave). Ose mund të zgjedhë që fëmija i shkretë, të cilën çifti po lufton për ta marrë, të jetë i zoti i historisë—ta rrëfejë divorcin përmes këndvështrimit të saj, edhe pse është tepër e vogël për të kuptuar atë që po ndodh (si tek libri **What Maisie Knew** [Çfarë dinte Meisi] të Henry James-it). Zgjedhja e një këndvështrimi, kur bëhet fjalë për një divorc, përbën kryesisht historinë e librit, por kur krijimi letrar është i suksesshëm, kjo histori nuk do të ishte një listë procesesh ligjore të një gjykate, mbushur me fakte, as një fjalim i gjatë i pa filtruar qarjesh kundër bashkëshortit të pabesë.

Ka gjithnjë një marrëdhënie treshe gjatë leximit të një libri: ju, autori dhe personazhi.

Nëse numri i personazheve të një romani është i madh, autori mund të funksionojë si një lloj planifikuesi gazmend feste, duke ju shoqëruar gjithandej, për t'ju prezantuar me njerëzit që mendon se mund të jenë interesant për ju, duke ju mbushur me adhurim për gjerësinë e vizionit të tij. Ai mund t'ju paraqitë edhe një gjenealogji që t'i keni mirë parasysht personazhet. Mund t'ju japë edhe kohën historike kur zhvillohen ngjarjet. Hilary Mantel ju jep personazhet bashkë me një diagrame për evolucionin e Tudorëve në fillim të librit **Wolf Hall**. E admironi Mantel-in që e ka bërë detyrën e saj të shtëpisë. Megjithatë, jeni plotësisht të vetëdijshëm se pavarësisht se sa e kujdesshme ka qenë puna kërkimore e saj, në fakt ajo nuk e di vërtet se çfarë hante për mëngjes Cromwell-i.

Autori është ndërmjetësues. Ai është udhërrëfyes dhe përkthyes - dhe kjo është e vërtetë edhe (ose siç do ta shohim

veçanërisht më pas) kur historia rrëfëhet në vetën e parë, ose përfshin fakte apo ndodhi historike.

Zgjedhja e këndvështrimit përfshin manipulimin e zotë dhe rregullimin e aleancave me personazhet. Në të vërtetë, për mendimin tim, këto manipulime përbëjnë vetë thelbin e letërsisë artistike dhe janë më qendrore dhe të qenësishme se sa subjekti – të cilat trillimi letrar, i cili sfidon besnikërinë ndaj autorit apo personazhet, arrin t'i bëjë plotësisht me sukses. Ndonëse kur shkruajmë, shumica jonë i bëjmë zgjedhjet e këndvështrimeve automatikisht dhe instinktivisht, duke i analizuar këto zgjedhje dhe duke i parë me kujdes opsionet që kemi, mund të mësojmë mjaft si për qëllimet tona, ashtu edhe për mënyrat më të mira për t'i arritur ato.

Një personazh mund ta urrejtmë, ose të mos e besojmë. Narratori mund të jetë i pabesueshëm për lexuesin në mënyra nga më të pakuptueshmet, deri tek ato më të dukshme. Megjithatë, autorin nuk mund ta urrejtmë apo të mos e besojmë. Kur urrejtmë autorin, urrejtmë librin. Kur autori na shoqëron deri tek vendet ku na takon të ulemi në një sallë shfaqjesh, shpresojmë të mos na vendosë pas një blloku të madh betoni nga ku nuk do të mund të shihnim veprimin që ndodh. Por, njëkohësisht, nuk do të donim as të shihnim një provë shfaqjeje. Duam që aktorët t'i kenë mësuar ato që duhet të thonë dhe të jenë të veshur me kostumet përkatëse. Ka një besim të madh, të nënkuptuar, në kontratën e bërë midis autorit dhe lexuesit. Nuk do të donim të na premtonte se do të zhbironim në zemrën e një personazhi dhe, në vend të saj, të na paraqitnin një histori ku personazhi vetëvritet. Nuk do të donim të na premtonte një histori e cila është, po të përdor mbiemrin që më vjen ndërmend në këtë çast, “e mërzitshme” por që, nga ana tjetër, mund të përfundonte me një çast të paharruar.

Zgjedhjet e këndvështrimeve mund t'i shihni si pika qëndrimi përgjatë një spektri apo shkalle lëvizëse:

Afërsi Largësi
Empati Gjykim
E brendshme E jashtme
Subjektive. Objektive

Zgjedhja e një këndvështrimi, kërkon nga ju të vlerësoni nëse po i afroheni, apo largoheni subjektit; nëse do ta nxisni lexuesin të kridhet në këndvështrimin e personazhit rreth botës, apo do të ofroni një këndvështrim plotësues apo edhe konkurrues me të tijin.

Autori është ndërmjetësues. Ai është udhërrëfyes dhe përkthyes – dhe kjo është e vërtetë edhe kur historia rrëfëhet në vetën e parë, apo kur përfshin fakte apo ndodhi historike.

Por, gjërat ndërlikohen dhe ja përse. Një mënyrë e pagabueshme për të na njohur me ndjenjat e personazheve është padyshim duke na lejuar të futemi në mendjet dhe shpirtrat e tyre - në fund të fundit kjo është edhe arsyeja përse marrim mundimin të lexojmë krijime letrare dhe jo gazeta. Sikundër pohon Atticus Finch në librin e tij **To Kill a Mockingbird** (Të vrasësh zogun këngëtar) “Pa i parë gjërat nga këndvështrimi i tjetrit, pa u futur në lëkurën e tij dhe pa menduar si ai, nuk arrin dot ta kuptosh vërtet një person ...” Një pjesë e mirë e këtij libri u kushtohet metodave për të arritur këtë njehsim me personazhin. Gjithsesi, rruga më e mirë drejt empatisë nuk është gjithnjë shkrirja dhe afërsia me të. Në mënyrë paradoksale, në disa raste, kur i afroresh shumë diçkaje, efekti mund të jetë më shumë largues se sa afrues. Ndonjëherë, duhet të largohesh nga diçka, për ta parë në tërësinë e vet, për të ndier realisht ndikimin e dëshiruar. Dhe jo të gjitha vëzhgimet nga larg, objektive, janë pa tjetër të ftohta dhe klinike. Ka raste kur edhe ato mund të krijojnë reagime të forta.

Të flasim për një çast me terma kinematografike. Kur filmi një puthje romantike, nuk doni që t'i afroheni aq shumë dyshe buzëbashkuar, sa t'u dalloni edhe qimet e flegrave të hundës. Atmosferën mund ta krijoni më mirë duke treguar dritat që ndriçojnë lehtë pas shpinës së tyre. Ndërsa, kur filmi një skenë të ngjashme, por me kamerën që lëviz me shpejtësi dhe befas fusni një pjesë buçitëse me violinë, audienca mund të mermëritë përbuzshëm për këtë klishe, në vend që të përjetojë një ndjenjë kënaqësi të hollë, romantike. Por, ajo që është veçanërisht e vështirë është të përçarit e këndvështrimit në mënyrën e duhur në një skenë

seksi, sepse skena të tilla pothuaj gjithnjë e kthejnë lexuesin në një vuajarist – edhe pse akti në fjalë është (të paktën në të shumtën e herëve) privat dhe eksitimi mund të mos jetë efekti që doni të arrini.

Por, kjo është njëherazi një situatë ku shkrimtari mund të krijojë idenë e vetëkënaqësisë për zotësinë e tij. Po e përdor përemrin “e tij” qëllimisht: të marrim Norman Mailer-in ose shkrimtarë të tjerë që njihen për një lloj vetëkënaqësie, të cilët ndonjëherë i akuzojnë se i gëzohen parezistueshmërisë dhe talentit të tyre për të kënaqur zonjat, dhe jo protagonistët e tyre, duke shkaktuar një farë bezdie të tjerët. Të kthehemi prapa tek diagramet Venn: lexuesi në këtë rast mund të kundërshtojë, për faktin që nuk ka një ndarje të mjaftueshme midis personazhit dhe autorit dhe se autori vetëm sa mburret ose merret me përmbushje dëshirash, duke u bërë si Austin Pauërs², një parodi e papërpunuar e burrit maço. (Jo, ti nuk je një ngordhalaq i kërrusur mbi lap-top! Ti je njeri i aksionit dhe misterioz, Shpirt!)

Po ashtu, nëse orvateni të paraqitni tmerret e një fushëbeteje, një pamje nga afër e klithmës së një burri teksa këmba i shpërthen në ajër (ndoshta me lëvizje të ngadalta) ndoshta nuk do të ishte aq e efektshme sa një pamje e marrë nga larg e fushëbetejës, me mijëra trupa që dridhen nga dhimbjet apo me fytyra zhytur në baltë – të paktën deri sa dhe kjo pamje të bëhet klishe e “Tmerrit të betejës” dhe të na bëjë të mos ndiejmë pothuaj asgjë, siç ndodh rëndom me klishetë. Nëse po përpiqeni ta paraqisni Katerinën që, pasi më në fund e gjeti kurajën për t’u arratisur nga Hithklilfi, po ecën e vetme nëpër shqopishte në mes të natës, nën një shi të rrëmbyer, milje larg sigurisë, mund të ishte mirë që në fillim të na tregonit me një kënd të gjerë se sa të mëdha janë këto shqopishte, apo sa ftohtë është aty.

Por, mbase mund të mos ishte mirë. Fakti i pakundërshtueshëm për zgjedhjet e këndvështrimeve është se ato janë të varura nga gjëra të tjera.

Përherë.

Shihni se sa shumë Emily Brontë e komplikon këndvështrimin e saj tek **Wuthering Heights** (**Lartësitë Uthering**): ajo rrëfen historinë e romancës së stuhishme të Katerinës dhe Hithklift jo nga këndvështrimi i njerit prej të dashuruarve, por nga këndvështrimi i Lokudit, një qiradhënës aty pranë që vinte nga Londra kozmopolitane, i cili e mësoi pjesën më të madhe të historisë së tyre nga Neli, një shërbyese lokale që e kish njohur Katerinën që të vogël – e cila nga ana e saj, i kish mësuar disa pjesë të rrëfenjës së saj nga shërbëtorë dhe vëzhgues të tjerë. Brontë të mban në ankth gjatë gjithë kohës, ta bën të vështirë ta besosh versionin e historisë që mëson në një çast të caktuar dhe në fakt, romani është shumë më pak gotik se sa pothuaj të gjitha versionet kinematografike të tij. Po të kini aftësi të shkëlqyera grafike, përpiquni ta vizatoni diagramën Venn për atë miriadë marrëdhëniesh.

Në mënyrë paradoksale, në disa raste, kur i afroresh shumë diçkaje, efekti mund të jetë më shumë largues se sa afrues.

Efekti i gjithë këtyre interpretimeve dhe përkthimeve është të krijojnë idenë se shkrimtari gati gati nuk ndodhet aty. Nëse nuk tregohesh i kujdesshëm, mund të harrosh faktin se Katerina dhe Hithklifi janë thjesht pjella të krijimtarisë së Brontë-së. Në të vërtetë, ajo përdor një marifet magjik për të na krijuar ndjesinë se po lexojmë versione të ndryshme të ngjarjeve që kanë ndodhur realisht. Sepse në të vërtetë, ato nuk ndodhin.

Ndërsa skllavëria ka ndodhur. Po si të shkruani mbi shëmtinë e saj dhe të na përfshini thellë në tmerret e përvojës së skllavërisë? Mund të zgjidhni të na fusni në kurth, pa përkthim apo ndërmjetësim, në turpin dhe dhimbjen e një njeriu të lidhur me zinxhirë, i detyruar të mbajë në gojë një fre si kalë, ose me pranga në këmbë, në një të ndarë në tokën e baltosur, gjatë një përmbytjeje të tërbuar. Të na përçoni ndjenjën e pranisë së menjëhershme. Por, në një rast të tillë rrezikoni që lexuesin ta bëni të ndihet sikur po i mbajnë leksion, apo edhe ta mpini ndaj dhimbjes. Pjesa e mahnitshme që flet për grupin e skllavëve të lidhur bashkë me zinxhirë në romanin e Toni Morrison-it **Beloved** (**E dashura**), që gëlon nga empatia lirike, vjen shumë vonë në romanin e saj të vendosur qëllimisht pas Luftës Civile, duke na dhënë një sërë narrativash të lidhura shumë ngushtë me njëra tjetrën, në vetën e tretë, duke na treguar se si



personazhe nga më të ndryshmet e përballojnë trashëgiminë e skllavërisë. Romani flet për mënyrën se si njerëzit mendojnë dhe flasin për pikëllimin dhe zemërimin, jo thjesht për tmerrin e përvojave në vetvete. Largësia kohore mund të jetë po aq e rëndësishme sa edhe largësia fizike në krijimin e besueshmërisë dhe gamës së autorësisë. Personazhet e Morrison-it janë vizatuar kaq bukur sa të duken të vërtetë, por lidhja jonë është pikësepári dhe kryesisht me vetë Morrison-in, me mprehtësinë dhe vizionin e saj. Romani synon të jetë njëkohësisht thellësisht personal në objektin e vet, por edhe të ketë gjerësi të pamat – duke na treguar një histori që është, siç thotë edhe përshkrimi në kapakun e tij, “po aq e fuqishme sa edhe Eksodi dhe po aq e dashur sa dhe një ninullë.”

E megjithatë, Cynthia Ozick, në tregimin e saj të shkurtër që të dhemb në shpirt, “Shalli”, qëllimisht nuk zgjedh të na japë një pamje më të gjerë. Roza është pjesë e një marshimi nazist drejt vdekjes, në një kamp përqendrimi, duke mbajtur fshehur në gji vajzën e saj foshnje, pas shallit që personifikon atë vetë. Ajo ka të ftohtë, po vdes nga të pangrënët, gjinjtë i janë tharë; foshnja e saj Magda, thith “shallin magjik” i cili e mban të qetë dhe gjallë. Jemi, të ngujuar jo vetëm në kurthin e këndvështrimit të Rozës, të vetëdijes së saj të reduktuar në shpresën e vetme të dëshpëruar për të shpëtuar foshnjën Magda, por edhe në qoshen e vendit të fshehtë. Përsëri, mund ta simpatizojmë Rozën, por lidhja jonë është me Omzick-un, e cila ka besim se do ta kuptojmë rëndësinë që ka shalli i lutjeve për fenë çifute, dhe kështu edhe rëndesën metaforike të tregimit; dhe gjithashtu, faktin që ajo ka thurur një tregim prej shtatë faqesh për të rrëfyer të gjithë traumën e humbjes së një jete të vetme, përkundrejt shkallës së paimagjinueshme të barabarizmit të kampit, duke na detyruar të njëjtësohemi plotësisht me një personazh të vetëm. Nëse doni të shihni një pamje më të gjerë, mund të shkoni të vizitoni muzeun e Holokaustit apo Shoah-un. Thellësia e tregimit të Ozick-ut nuk qëndron thjesht në atë që ajo na bën të ndiejmë në lidhje me barbaritë e Gestapos (Sa tragjike është edhe një vdekje midis gjashtë milion vdekjesh për atë që është duke vdekur, apo edhe më keq akoma, për atë që po humb fëmijën e saj?), por në atë që kërkon të mendojmë për marrëdhënien e krijimit letrar me përjetimin: Sa dhimbje dhe pikëllim mund të përmbajë një tregim i shkurtër?

Zërin e autorit e dëgjojmë në një formë krejtësisht të ndryshme në një libër me një subjekt shumë më të qetë dhe me një rrjedhë më pak dramatike, siç është libri i Alice McDermott-it **Charming Billy** (**Billi i lezetshëm**). Ne fillojmë dhe e dashurojmë dhe na dhimbset kjo familje irlandeze nga Kuinsi. Na duket sikur janë fqinjët tanë, pavarësisht në jemi apo jo irlandezë, apo nga Kuinsi. McDermott na jep një premtim krejt të ndryshëm. Ajo na siguron se jetët e zakonshme me një dëshpërim të qetë janë të rëndësishme. Ndihe mi rënjohës ndaj saj që na shtyn t’u avitemi kaq pranë. Vlerësojmë gjithashtu edhe një farë modestie dhe vetëmohimi në mënyrën e rrëfimit të autores. Si një terapistë e mirë, duket sikur McDermott rri në hije, duke i lënë personazhet të nxjerrin përfundimet e tyre.

Largësia kohore mund të jetë po aq e rëndësishme sa largësia fizike në krijimin e besueshmërisë dhe të objektit autorial.

Ndonjëherë, njëlloj si personazhet, edhe ne çuditemi nga ndonjë perceptim – dhe ndonjëherë nxitemi të shohim gjëra që ata nuk i shohin. Do të flasim për aftësinë për t’u dalë gjërave përpara dhe për teknika të tjera që i mundësojnë autorit t’i qëndrojë besnik perceptimit të ngjarjeve nga një personazh, por që ndërkohë, u dërgon sinjale lexuesve për të parë përtej asaj që vetë personazhi percepton. Kur të dhënat e tij janë tepër të dukshme, bëhen ndërhyrëse. Kur janë tepër të padukshme, na shpëtojnë pa i parë dhe kur vjen fundi, mosdija e tyre nuk na trondit; përkundrazi, ndiejmë mërzit apo zhgënjim.

Në një tregim si ai i John Cheever-it “**The Swimmer**,” (Notari), ne shkojmë sa nga pishina e një lagjeje, në pishinën e lagjes tjetër në periferinë e gjelbëruar në shoqërinë e Donald Uestharzinit, i cili është pijanec dhe me shumë paaftësi. Por, tekefundit, ne i kemi mendtë në kokë dhe pjesë e lezetit të historisë është të kuptuarit përpara Uesterheizit se diçka nuk shkon aspak mirë në jetën idilike të tij. Idetë që na jepen në të sa venë e shtohen. Kënaqësia që ndiejmë është zotësia me të cilën Cheever-i i shpalos zbulosat e tij. Kthehuni pas tek diagrami Venn: në këtë rast ju dhe autori jeni duke bërë kryesisht not pash përkrah Uestereheizit, por rrethi ynë dhe rrethi i tij nuk mbivendosen plotësisht dhe tërësisht. Është njëlloj sikur të kini vështrim periferik dhe të shihni përtej kuadrit të dukshëm të tregimit.

Dhe pastaj e rilexoni. E përpini gjithë kënaqësi. Përsëri, idetë që ju jepen sa venë e shtohen, por në mënyrë të ndryshme. “Idetë paralajmëruese” nuk ndryshojnë asgjë në vlerësimin e një krijimi të mirë letrar. Në fakt, bëjnë krejt të kundërtën: kur e dini atë që vjen pas, tensionin e përjetoni edhe më shumë. E kam rilexuar disa herë librin e Flannery O’Connor-it “**A Good Man Is Hard to Find**” (Një njeri i mirë është vështirë të gjendet) pasi mësova që në fillim se të gjithë personazhet nxitojnë drejt vdekjes, por nuk me duk sikur më mashtruan dhe nuk u mërzita për këtë gjë.

Alfred Hitchcock ka folur për dallimin midis befasisë dhe ankthit dhe se përse ankthi është arritja më e rëndësishme në një film. Nëse shohim katër burra të ulur në një tavolinë duke luajtur poker dhe skena na duket e mërzitshme deri sa, befas plas një bombë, kjo do të ishte një befasi. Por “nëse shohim të njëjtën skenë përsëri, por me një ndryshim të rëndësishëm, vënien e bombës nën tavolinë dhe kohëmatësin e vendosur në orën 11 të mëngjesit dhe në sfond dallojmë një orë, e njëjta skenë bëhet shumë e tensionuar, gati e papërballueshme . . . kjo quhet pritje e ankthshme”.

Këndvështrimet në filma dhe letërsi ndryshojnë në mënyra rrënjësore. Megjithatë, dallimi që bën Hitchcock-u vlen edhe për letërsinë. T’u japësh lexuesve të dhënat që u duhen për të interpretuar plotësisht një skenë, tregon një

² Personazh që personifikon dashurinë e lirë.

“Elementet që ne përdorim në teatrin arbëresh janë ato që kanë të bëjnë me jetën e përditshme, me mënyrat e të folurit, me situatat që mund të shpjegojnë, edhe në mënyrë alegorike, gjendjen tonë ekzistenciale. Por, teatri në gjuhën arbëreshe është gjithashtu i rëndësishëm për mbrojtjen e gjuhës sonë. Sepse aktori studion një dramaturgjë arbëreshe. Dhe, për këtë arsye, ai ka mundësinë të fusë termat e humbur në kompetencën e tij gjuhësore. Shikuesi, gjithashtu përfiton, sepse ai i dëgjon këto terma nga goja e aktorit dhe, mbase, mund t’i përdorë përsëri.”

MARIO CALIVA:

Teatri në funksion të ruajtjes së kulturës arbëreshe

Bisedoi: Mimoza Hasani Pllana



Mimoza Hasani Pllana: Mario, jeni nga banorët e rrethinës së Palermos që me përkushtim të madh kontribuoni në vazhdimin e ruajtjes së gjuhës dhe traditës arbëreshe dhe promovimin e saj. Tanimë keni realizuar disa shfaqje teatrale duke vënë në skenë pjesë nga jeta arbëreshe. Cilat janë elementet që keni marrë nga identiteti arbëresh dhe i keni vënë në skenë?

Mario Caliva: I pari element që merr dramaturgu është gjuha. Sepse teatri është një gjë, një ngjarje artistike, që përdor, përveç gjuhëve të tjera skenike, fjalën. Fjala është përfaqësimi i veprimeve verbale të aktorit. Mediumi i mendimit të dramaturgut që derdhet në botën magjike të veshit. Edhe nëse teatri ka lindur si diçka për të parë dhe për të mos dëgjuar.

Elementet që ne përdorim në teatrin arbëresh janë ato që kanë të bëjnë me jetën e përditshme, me mënyrat e të folurit, me situatat që mund të shpjegojnë, edhe në mënyrë alegorike, gjendjen tonë ekzistenciale. Por, teatri në gjuhën arbëreshe është gjithashtu i rëndësishëm për mbrojtjen e gjuhës sonë.

Sepse aktori studion një dramaturgjë arbëreshe

dhe për këtë arsye, ai ka mundësinë të fusë termat e humbur në kompetencën e tij gjuhësore. Shikuesi, gjithashtu përfiton, sepse ai i dëgjon këto terma nga goja e aktorit dhe, mbase, mund t’i përdorë përsëri.

M.: Te libri Nostaligia, përmes poezive rifreskoni kujtimet e brezave paraardhëse shoqëruar me emocione personale, a do të thotë se nuk dëshironi të ndaheni nga tema arbëreshe as në poezi?

M.C.: Nostaligia është një përpjekje për të kapur ndjenjat e Arbëreshës së parë që u largua nga Shqipëria me forcën e imagjinatës së poetit ose shkrimtarit, pas përparimit të turqve.

Ai përfaqëson një lidhje midis ndjenjave të dy kohëve të ndryshme, të cilat megjithatë janë një dhe e njëjtë. Sepse edhe sot nuk kemi harruar kush jemi dhe kush ishim. Për ne poezia arbëreshe është e rëndësishme, veçanërisht nëse ruan lidhjen me identitetin. Por, unë gjithashtu jam marrë me poezi në italisht, kam fituar disa çmime letrare dhe kam botuar pesë përmbledhje me poezi. Përmbledhja ime e parë me poezi arbëreshe do të dalë së shpejti.

M.: Si poet, shkruani në dy gjuhë. Dygjuhësia të krijon dyfishim të mundësive të komunikimit me

lexuesin, pra është një privilegj. Por, çfarë ndjesie është për poetin të shkruajë paralelisht në dy gjuhë?

M.C.: Mendoj se për një shkrimtar, të shkruarit në dy gjuhë është një privilegj i madh. Aq më tepër nëse ajo gjuhë është po aq e çmuar sa e jona. Sepse, dihet mirë se diamantet janë të çmuar sepse janë të rrallë. Unë do të vazhdoj të shkruaj në Arbërisht, për të dhënë një kontribut të vogël në mbijetesën e saj të madhe.

M.: Kur shkruani arbërisht dhe kur italisht?

M.C.: Në italisht kam shkruar disa libra: një mbi hebrenjtë e Romës, një tjetër mbi masakrën e parë shtetërore në Portella della Ginestra më 1 maj 1947, ku edhe arbëreshë humbën jetën. Kohët e fundit kam mbaruar së shkruari romanin tim të dytë në italisht. Në Arbërisht shkruaj teatër dhe poezi. Po shkruaj edhe tregime të shkurtra në gjuhën arbëreshe, si Dubliners e James Joyce. Unë dua të përpiqem të tregoj historinë e përditshme e Horës dhe Arbëreshëvet siç bëri shkrimtari i madh i përmendur më lart. Padyshim me përmasat e duhura. Sidoqoftë,

Mario Calivà është një poet dhe dramaturg arbëresh. U diplomua për Dramaturgjë dhe Skenar në Akademinë Kombëtare të Artit Dramatik "Silvio d'Amico" në Romë. Përveç titullit Doktor i Ekonomisë dhe Financave mori dhe një diplomë universitare në Disiplinën e Shfaqjes me një tezë mbi Teatrin Arbëresh si vektor i komunikimit të identitetit. Që nga viti 2012 ka vënë në skenë shfaqjet e tij në gjuhën arbëreshe. Ka botuar disa koleksione poezish në gjuhë italiane dhe dy vëllime; njeri për dëshmitë e të mbijetuarve nga masakra e parë shtetërore e Portella della Ginestra më 1 maj 1947 (Portella della ginestra, Primo maggio 1947, Navarra) dhe tjetri për ligjet raciale italiane, internimet e vrasjet e hebrenjve të Romës gjatë Luftës së Dytë Botërore (Le Leggi razziali el'ottobre del 1943, Besa). "Rrëmbyesi dhe Ara" (Botimet OM) është shfaqur si dramë dhe monolog në gjuhën shqipe në Kosovë dhe Shqipëri.

Në vitin 2020 botoi librin e suksesshëm "Nostaligia". Calivà ka punuar në redaksinë Rai Cultura të Romës.



është gjithashtu e vërtetë që gjuhët mund të jenë së bashku në një tekst. Në fakt, unë shkruajta një tekst teatral, tema e tezës sime të diplomës në Dramaturgji dhe Skenar në Akademinë Kombëtare të Artit Dramatik në Romë, me titull "Il canto della ginestra", ku ka skena në italisht, arbëreshë, anglisht dhe Sicilian.

M.: Meqë zotëroni këtë kompetencë, a keni provuar të përktheni poezinë shqipe në gjuhën italiane?

M.C.: Do të më pëlqente të përktheja disa vepra të rëndësishme.

M.: Realizoni edhe fotografi nga aktivitetet tradicionale arbëreshe, duke veçuar kostumin e grave arbëreshe, çfarë e karakterizon atë?

M.C.: Padyshim kuptimi. Kjo është veshja e festës së Pashkëve. Veshja me të cilën gruaja arbëreshe i paraqitet Zotit para se të martohet me burrin e saj. Ato janë veshje shumë të çmuara të qëndisura në ar, nga duart e afta të rrobaqepësve arbëreshë. Një traditë shumë e rëndësishme në të cilën elementet tokësore dhe transhendentale bashkëjetojnë. Kur gruaja arbëreshe vesh veshjen tradicionale, ajo shënon një boshllëk në kohë. Dhe ai ofron përjetësinë për të gjithë prejardhjen e tij.

M.: Pasioni juaj për artin shpërndalet tek drama, poezia dhe fotografia, cili është profesioni juaj dhe cili pasioni më i dashur?

M.C.: Poezia. Sigurisht. Por, fatkeqësisht është ai që konsiderohet më pak nga të gjithë. Poezia është një kohë tjetër. Një zbulim. Një takim i panjohur që bëhet i njohur falë vargjeve. Por, shkrimi është gjithmonë një kufizim dhe ky zbulim mbetet, pjesërisht, në një nivel prelinguistic. Dhe kjo është pjesa më misterioze: fjalët që nuk janë thënë kurrë, por që kanë kuptim në frymë.

M.: Si poet i ri, sa jeni aktiv në takimet letrare që mbahen në Kosovë, Shqipëri dhe qendrat tjera shqiptare?

M.C.: Kam disa kontakte me botues, aktorë, poetë, shkrimtarë dhe artistë shqiptarë dhe kosovarë. Disa muaj më parë në Universitetin e Arteve në Prishtinë, një nga tekstet e mia teatrale u zgjodh si një test për provimet e studentëve. Unë gjithashtu kam bashkëpunuar me Teatrin Kombëtar të Tiranës në të cilin kam dërguar disa video në të cilat recitoj poezitë e mia për një ngjarje të organizuar në internet. Unë besoj se shkëmbimi kulturor dhe artistik është i rëndësishëm. Sidomos midis arbëreshëve dhe shqiptarëve.

M.: Mario, viteve të fundit kur masmedia është një nga format më të shpeshta të komunikimit, jeni bërë një nga pikat komunikuese ndërlidhëse mes arbëreshëve të Sicilisë dhe medias shqiptare. Përmes komunikimeve tashmë të shpeshta jeni duke promovuar kulturën dhe traditën arbëreshe gjithandej. Prej nga gjithë ky vullnet dhe dëshirë e mirë?

M.C.: Është e natyrshme që unë të flas për origjinën dhe kulturën time. Dhe besoj se nëse çdo arbëreshë bën diçka, ne me të vërtetë mund të shpresojmë të ekzistojmë edhe në 500 vjet të tjera. Sidoqoftë, çdo kulturë duhet të jetë e hapur për dialog, ndarje dhe respekt për popujt e tjerë. Vetëm në këtë mënyrë mund të ketë një kulturë të denjë për t'u ruajtur dhe projektuar me kalimin e kohës.

(Vijon nga faqja 21)

lloj respekti për inteligjencën dhe mprehtësinë e tyre. Kjo do të thotë se vetë subjekti përfshin vendime të rëndësishme lidhur me këndvështrimin: sa dhe kur do t'i tregosh lexuesit. Ja një pikëpamje e qartë, por e rëndësishme për sa u takon ideve paralajmëruese: vetë fakti që janë të aty, të pranishme, do të thotë se autori e di se çfarë do të ndodhë. Ai nuk i shpik ato gjatë rrugës. Krijimi letrar përfton një lloj dendësie të shtresëzuar, duke filluar të ndihet më pak si një marrëveshje artificiale dhe më tepër jetësor, ku një person i vërtetë jeton si përpara edhe pas një skene që zhvillohet. Ne jo vetëm që përfshihemi në të që në krye të herës, por besojmë se përfshirja jonë do të na shpjerë diku. Se autori nuk do t'i bjerë pafundësisht një note të vetme, si të ishte një grupi i keq muzike metal; se, sidomos, gjërat më në fund do të zgjidhen edhe kur zgjidhja është e tillë që na lë të kuptojmë se në të vërtetë nuk ka një zgjidhje.

T’u japësh lexuesve të dhënat që u duhen për të interpretuar plotësisht një skenë, tregon një lloj respekti për inteligjencën dhe mprehtësinë e tyre.

Shkrimtarët e mëdhenj e dinë momentin kur duhet të futen në lojë dhe kur të tërhiqen. Ata e manipulojnë distancën. Nuk u bien tepër vibrato telave të zemrës, sepse kjo pothuaj përherë do të bëhej shkas për sentimentalizëm. Ata e dinë kur informacioni klinik bëhet i tepruar, edhe në lidhje me një subjekt ku faktet janë shumë të rëndësishme, - sepse në këtë rast, do të kishim një tekst historie dhe jo një roman. Por tani, mjaft me autorin dhe personazhin. Çfarë mund të themi për ju? Më lart, thashë që lexuesi – po e quajmë “ti” – është gjithnjë vetëm kur lexon por, ndonëse kjo është e vërtetë kur shfleton faqet e asaj që lexon, në fakt është vetëm pjesërisht e vërtetë. Mund të të duket sikur librin po e lexon bashkë me vëllezër e motra me të cilët ke mendime të njëjta. Kjo mund të ndodhë kur je duke lexuar një bestseller, një libër të bujshëm – siç është rasti me miliona njerëz të zhytur në leximin e librave të Harry Potter-it, kur është më e vështirë të mendosh se J.K. Rowling e ka krijuar Harrin vetëm për kënaqësinë tënde personale. Ka edhe romancierë kult, lexuesit e të cilëve kanë disa veçori apo besime të përbashkëta, siç janë njerëzit e mësuar me frymëzimet jo dhe aq inteligjente, të mbushur me dashuri për zotin, të llojit të Anne Lamott-it, ose gratë beqare që pëlqejnë vështirësitë e skenave dashurore të përshkruara në filmin e Candace Bushnell-it **Sex and the City** (Seksi dhe qyteti), apo njerëzit e palatuar që jepen pas vizionit distofik të Cormac McCarthy-it. Për lloje të ndryshme humori, mund t'i drejtohesh librit të një shkrimtari të cilit ia njeh humorin dhe që të bën të qeshësh. Nuk është saktësisht rutina e zakonshme e një komiku që del i vetëm në skenë dhe që me fjalët e tij e bën audiencën të shkrimet gazit, ku njeriu rrethohet nga britma kolektive miratimi dhe kënaqësie, por edhe në këtë rast, autori të drejtohet ty si person, me qëllim që të bësh të tuat disa thënie të tij mbi absurditetin e botës që, në atë mjedis disi të pak marramendës, të duket se i kanë të gjithë.

Si lexues, pret që të të kushtojnë vëmendje, të të marrin me të mirë – të të joshin. Ja se ç’thotë teoricieni francez Roland Barthes në **The Pleasure of the Text (Kënaqësia e tekstit)**: Nëse e lexoj me kënaqësi një fjali, një tregim, apo një fjalë, kjo vjen për shkak se është shkruar me qejf. . . Po e kundërta? A më garanton mua, shkrimtarit, - një shkrim i shkruar me qejf, - kënaqësinë e lexuesit? Aspak. Mua më duhet ta kërkoj këtë lexues (ta “gjej”) pa e ditur se ku ndodhet. Në këtë mënyrë krijohet një vend kënaqësie. Mua nuk më duhet “personi” i lexuesit, por pikërisht ky vend kënaqësie: mundësia e dialektikës së dëshirës, e paparashikueshmërisë së kënaqësisë: bastet nuk janë vënë ende, ka ende kohë për një lojë. A mund ta quajmë “vendin e kënaqësisë” të Barthes-it atë pjesë të diagramit Venn ku shkrimtari dhe lexuesi janë “në të njëjtën linjë”? Ndjesia se shkrimtari flet me ty – të kupton – është kritike. Për se të çmon shkrimtari? Për fjalorin e përdorur, për pafundësinë e aludimeve letrare, apo për kuadrin historik të referencave? Për çfarë lloj përvojash, besimesh, shqetësimesh? Ndonëse shkrimtari nuk të drejtohet drejtpërdrejt, ti do

të besosh se ai ndjek me respekt praninë tënde, duke gjurmuar reagimet e tua. Nuk do që të ndihesh sikur po të llo-motit një i huaj i ulur pranë teje në avion. Nuk do as të ta prishi mendjen një shitës mashtrues (po ta përditësoj këtë sot, do të thosha, nuk do të bombardohesh me spame për një produkt që rrit penisin). Kam dëgjuar shpesh studentët e mi të ankohen se një roman, i cili ka ecur jashtëzakonisht mirë është kot fare, se edhe vetë ata mund të shkruanin symbyllur dhe tapë një libër më të mirë. E vërteta është se, të “shkruash thjesht” në mënyrë të suksesshme, është tmerrësisht e vështirë - gati e pamundur. T’i kthehemi përsëri paktit që bëmë me lexuesin: përpjekje të tilla në të shumtën e rasteve dallohen menjëherë se janë të pasinqerta. Lexuesi do ta kuptonte menjëherë se ju mendoni se subjekti apo proza është “shumë e mirë për ta”. Oprah beson në librat që u bën reklamë; ajo nuk i flet kurrë audiencës nga lart. Lexuesi juaj mund të mos ketë qiellzën më të rafinuar në botë, por kjo nuk do të thotë se me fjalë të bukura do të bindet që të ulet e të hajë një ushqim për fëmijë në tryezën e fëmijëve.

Shkrimtarët e mëdhenj e dinë momentin kur duhet të futen në lojë dhe kur të tërhiqen. Ata e manipulojnë distancën. Nuk u bien tepër vibrato telave të zemrës, sepse kjo pothuaj përherë do të bëhej shkas për sentimentalizëm.

Kështu e di edhe ti. Po, po me ty po flas. Mos je duke punuar me seriozitet për një roman dhe ke arritur tek faqja 500, duke mos qenë plotësisht i sigurt ku po shkon dhe çfarë të heqësh prej tij, por duke e ditur gjithashtu se historia rrëfëhet nga dy këndvështrime të ndryshme, njëri në vetën e parë dhe tjetri në të tretën; kur profesori në shkollë të ka thënë me këmbëngulje që ta ndryshosh, por ti nuk e kupton përse duhet ta bësh; kur shumë autorë që i adhuron, kanë përdorur këndvështrime të ndryshueshme, përse të mos ta bësh edhe ti? Vepra që ke në dorë, mos është pak a shumë autobiografike (abuzimi seksual në fëmijëri, internimi nga vendlindja, lufta me varësinë), por ti ndoshta nuk ndihesh rehat të shkruash për disa gjëra në kuadër të rrëfimit dhe nuk e ke gjetur mënyrën për ta kthyer rrëfimin tënd në letërsi, të paktën jo në mënyrë bindëse? Kur them “Me ty po flas” supozoj se e kap aludimin tim tek filmi **Taxi Driver (Shoferi i taksisë)**, nëse jo, kërko një klip të tij në YouTube. Ndonëse këtu do t’u referohem shumë shembujve të veprave letrare, gjithsesi, nuk dua ta teproj ne kampione të gjata tregimesh. Nëse një pjesë e caktuar letrare të duket me shumë vend për problemet që mund të kesh me të shkruarit, besoj se mund ta gjesht vetë. Jo çdo shkrimtar që ka vënë penën mbi letër do të citohet këtu. Disa prej shkrimtarëve të mi më të parapëlqyer mungojnë këtu, por nuk kam ndërmend të jem enciklopedike. Për më tepër, jam e bindur se në një shkrim të mirë, çdo fjali është e mirë dhe zgjedhjet e këndvështrimeve mishërohen në çdo frazë, në çdo imazh të tij. Në të nuk ka “mbushës”. Jo vetëm besoj se edhe nga një kampion i vogël i një shkrimi mund të kuptosh shumë, por edhe se kjo është mënyra më e mirë për të mësuar zanatin. Puna në nivel mikro, të detyron të përqendrohesh realisht. Nuk mund ta ngatërrosh kurrë një fjali të Marcel Proust-it me një fjali të Stephen King-ut. Duhet të jesh në gjendje që atë fjali të Proust-it apo King-ut ta marrësh dhe ta ekstrapolosh për të gjithë veprën, sikundër bën një arkeolog që rindërton skeletin e një brontosauri nga një fosil, apo një detektiv i një vrasjeje të paramenduar, i cili merr një fije floku për ta analizuar në laboratorin mjeko-ligjor që të gjejë ADN-në.

Të marrim rreshtin e parë të një tregimi të shkurtër të një studenti universitar që kam vite që e mbaj pranë: Burri iku me vrap mes përmes pyllit të mjegullt. Ky rresht më shtyn jo vetëm të dua të jap lëndën e gaze-tarisë, për të diskutuar rreth pesë W-ve³ të nevojshme të fjalisë hapëse (Kush? Çfarë? Kur? Ku?), por edhe të mendoj për ndryshimin midis krijimit letrar dhe gazetarisë. Më së shumti, ai më bën të mendoj për këndvështrimet. Cili njeri? Kush po vështron? A është kjo një përrallë? (Nuk e di pse, po atë njeri e përfytyroj me një peliçe hedhur vitheve). Dhe kur, i dashur autor, do të na tregosh sa nga kush po ikën ai me vrap? Por, po të mendohem mirë, është një rresht i parë disi intrigues. Mund të arrija të lexoja deri te rreshti i dytë.

3 W, germa e parë në anglisht e pesë përemrave pyetës.

Të dielën, më 16 maj 2021, ora 18.00

**në Galerinë e Qendrës për Kulturë të Ulqinit në Malin e Zi,
bashkëbisedojmë për pandeminë dhe përvojat personale të përballjes
me armikun e shekullit, Koronavirusin e rrezikshëm e të pabesë.**



BOTIMET
TOENA

FTE SË

Takim me autorin e librit

DITARI *i përbaljes me* KORONAVIRUSIN


55 ditë në luftë me armikun e panjohur

“Lexojeni Ditarin e Fatmir Toçit. Kjo është vepër e intelektualit me dhunti të dëshmuar krijuese.”

Rexhep Qosja

e diel, 16 maj / ora 18:00

në Galerinë e Qendrës për Kulturë, Ulqin



FATMIR TOÇI - DITARI I PËRBALLJES ME KORONAVIRUSIN

(55 ditët e mia në luftë me armikun e panjohur)

Fragment nga parathënia e prof. Rexhep Qosja

“Ditari i Fatmir Toçit është ftesa më e rëndësishme, më konkrete, më thelbësore, që u drejtohet në gjuhën shqipe shqiptarëve për të respektuar masat e dhëna prej mjekëve, e të miratuara prej qeverive nëse duan të mbrojnë veten e të mbrojnë të vetët, kolegët e miqtë, të tjerët që takojnë, prej virusit vdekjeprurës Kovid -19. Është e kuptueshme, prandaj, pse në Ditarin e Fatmir Toçit janë aq të shpeshtë emrat e mjekëve, shprehet një nderim ndaj mjekëve e infermierëve - këtyre heronjve të kësaj kohe. Në Ditarin e tij, në këtë roman dokumentar historik mbi një virus, që atij ia rrezikoi jetën, Fatmir Toçi do t’u shprehë falënderime kolegëve, miqëve të tij, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Greqi, në Luginë të Preshevës, ndër fshatrat e arbëreshëve të Italisë, edhe në diasporën shqiptare

në Europë, në Turqi, në SHBA, të cilët u interesuan për shëndetin e tij, për jetën e tij.

Lexojeni Ditarin e Fatmir Toçit. Kjo është vepër e intelektualit me dhunti të dëshmuar krijuese. Kjo është vepër me vlera shkencore dhe artistike. Kjo është vepër që do të ketë ndikim shoqëror dhe etik. Prej luftës që përshkruhet në të për t’i shpëtuar Vdekjes do të çmojmë Jetën. Ajo, Jeta, është shumë e vlefshme, shumë e rëndësishme. Jeta, është shumë e bukur. Dhe, duhet të përpiqemi, ta ruajmë vlerën e saj, rëndësinë dhe bukurinë e saj. Dhe, ta mbrojmë prej të këqijave e rreziqeve që mund t’i vijnë prej anëve të ndryshme, ashtu siç e mbrojtën mjekët e infermierët prej virusit Korona Jetën e Fatmir Toçit. “